

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 E hënë, 20 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se erdhët.

7 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
9 çështja gjyqësore KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar  
10 kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Pikë së pari, do shohim kush është i pranishëm në sallën  
14 e gjyqit.

15 Ju lutem të filloj Prokuroria.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.  
17 Mirëmëngjes, ju që jeni brenda dhe jashtë sallës së Gjykatës.  
18 Prokuroria këtu ka znj. Kimberly West, që është Prokurorja e  
19 re e Specializuar, Line Pedersen, Gaia Pergolo, Filippo De  
20 Minicis, Prokuror dhe unë, Cezary Michalczuk, po ashtu  
21 Prokuror.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Mbrojtësi i Viktimave?

25 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Jam z. Simon Laws, jam

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 Avokati i Viktimave në këtë çështje gjyqësore.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Mirëmëngjes, të nderuar

6 Gjykatës. Këtu jemi me z. Shala që na ndjek nga objekti i

7 paraburgimit. Unë jam z. Gilissen. Jam këtu me znj. Cariolou

8 bashkëmbrojtëse, me z. Aouini edhe kam dhe ekipin tjetër

9 Kolbe, Petravica, Kailin Chen, asistentë edhe znj. Healy. Ju

10 faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Z. Shala, mirëmëngjes. A më dëgjoni mirë?

14 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

16 ju dëgjova. Mund ta përsërisni?

17 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Ju ndëgjoj mirë.

18 Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

20 Shala, ju lutem përsëriteni dhe një herë. Na dëgjoni mirë?

21 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes, ju ndëgjoj

22 shumë mirë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe

24 unë ju dëgjoj tani. Shkëlqyeshëm.

25 Sot do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes me

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 numër 03887, që është z. Zijadin Hoxha. Z. Hoxha do të japë  
2 dëshmi pa masa mbrojtëse në sallën e gjyqit. Përpara se të  
3 filloj, Trupi Gjykses do të thotë për procesverbal dy vendime  
4 që janë lëshuar në korrespondencë me ekipet e tjera po që  
5 është e nevojshme që t'i themi në dokumentacionin gjyqësor,  
6 pra, në procesverbal.

7 Të dyja kanë lidhje me dëshminë e dëshmitarit. Pikë së  
8 pari, ne rikujtojmë udhëzimin që i dhamë Mbrojtjes sa i takon  
9 marrjes në pyetje të z. Hoxha. Kemi dërguar një email, ne nga  
10 ana e Trupit Gjykses, që ka pasur lëndën CRSPD 126. Ka lidhje  
11 me materialin audioviziv që Mbrojtja synon t'i tregojë  
12 dëshmitarit. Ne udhëzuar Mbrojtjen që të përdorë vetëm pjesë  
13 të caktuara apo segmente të caktuara të videos, pra, të mos  
14 shfaqë të gjithë videon për hir të kohës së seancës.

15 Ky është vendimi i parë.

16 Vendimi i dytë, Trupi Gjykses refuzon kërkesën e  
17 Mbrojtjes për shtyrjen e afatit, për zgjatjen e afatit për t'i  
18 bërë pyetje z. Hoxha. Është numri F00706. Dhe Trupi Gjykses ka  
19 dërguar një email me lëndën CRSPD 131, për arsye se Mbrojtja  
20 nuk ka thënë cilat janë këto rrethanat e reja që do të  
21 përlligjnin ndryshimin e vendimit të Trupit Gjykses.

22 Mbrojtja ka katër orë për t'i bërë pyetje. Dhe në qoftë  
23 se bëhet e dukshme që Mbrojtjes i nevojitet më shumë kohë për  
24 të përfunduar pyetjet e veta, sigurisht që Mbrojtja mund të  
25 kërkojë kohë. Ne gjithmonë kështu kemi vepruar, nuk kemi pse

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 të veprojmë ndryshe kësaj here.

2 Seancat do të jenë nga një orë e gjysëm secila me ato  
3 pushimet e rregullta.

4 Dhe tani mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit.

5 Shoh që është në këmbë z. Prokuror. Z. Prokuror, fjala  
6 është për ju.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kemi një pyetje, na jepni disa  
8 udhëzime sa i takon emailit që keni dërguar ditën e premte. Në  
9 email na udhëzuat të përgatisnim një dokument në një formë të  
10 caktuar sikurse na dhatë udhëzimin tuaj. Ne i analizuam  
11 mundësitë teknike sesi ta realizonim dhe a mund të sugjeroj që  
12 të përgatisim të njëjtin dokument të redaktojmë fjalën që nuk  
13 duhet thënë në dokument dhe ta nxjerrim me të njëjtin numër po  
14 t'i vendosim prapashtesën RED.

15 Sepse në qoftë se e vendosim me numër të ri, do humbasim  
16 cilësinë e imazhit, nëse e rruajmë me emërtimin që thashë unë,  
17 imazhi ngelet me cilësi të mirë dhe nuk do të kemi asnjë  
18 problem pastaj me dëshmitarin që të komentojë për fotografinë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
20 rregull. S'ka asnjë problem, kështu mund ta bëjmë.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Asistente ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

24 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 5

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 Dëshmitar, mirëmëngjes. Mirë se erdhët në Dhomat e  
2 Specializuara. A më dëgjon?

3 DËSHMITARI: Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
5 Shala, e dëgjuat përkthimin e përgjigjes së dëshmitarit?

6 I akuzuari:[Përmes videolidhjes] Po. Po, e ndëgjova.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
8 mirë.

9 Dëshmitar, si jeni?

10 DËSHMITARI: Mirë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot  
12 do të fillojmë me dëshminë tuaj. Besoj se do jemi bashkë edhe  
13 ditën e nesërme. Para se të fillojmë me pyetjet unë kam disa  
14 këshilla për ju.

15 DËSHMITARI: Në rregull.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
17 kemi thirrur të jepni dëshmi përpara Dhomave të Specializuara  
18 në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Pjetër  
19 Shalës që ndihmoni Trupi Gjykses që të dalin në një vendim.

20 Ne, fillimisht, do ju kërkojmë të bëni deklaratën solemne  
21 që do të thoni të vërtetën dhe më pas do t'ju bëj pyetje  
22 Avokati Mbrojtës i z. Pjetër Shala, që është ulur në atë krah,  
23 përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar nga ana  
24 tjetër, Avokati që përfaqëson viktimat në këtë çështje  
25 gjyqësore dhe në fund edhe Gjykatësit që janë në panel. Në

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 rregull?

2 DËSHMITARI: Në rregull.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Përpara se të bëni deklaratën solemne, do t'ju jap edhe disa  
5 këshilla të mëtutjeshme dhe disa udhëzime praktike sesi t'u  
6 përgjigjeni pyetjeve, më dëgjoni me vëmendje.

7 Dëgjoni me vëmendje pyetjet që do ju bëjnë. Nëse nuk e  
8 kuptoni, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet.

9 Ne duam që të na thoni të vërtetën, të na thoni çfarë  
10 keni parë me sytë tuaj, çfarë keni përjetuar, çfarë keni  
11 dëgjuar ju vetë. Nëse ju nuk e keni parë apo dëgjuar diçka  
12 vetë, personalisht, na thoni sesi e keni zbuluar këtë  
13 informacion. Mbase nuk do ju kujtohen të gjitha hollësitë e  
14 ngjarjeve dhe kjo është krejt normale, mos jepni dëshmi për  
15 gjërat që nuk ju kujtohen. Mos hamendësoni, mos trilloni  
16 gjëra. Është normale që dhe të thoni "Nuk e di", "Nuk më  
17 kujtohet".

18 DËSHMITARI: Në rregull.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

20 lutem përgjigjuni vetëm pyetjes që ju drejtojnë, nëse  
21 Gjykatësit apo Avokatët apo Prokurorët kanë nevojë për hollësi  
22 të mëtejshme, ju bëjnë ata pyetje që ta sqaroni më tej, kështu  
23 që ju lutem jepni përgjigje koncize.

24 Po ashtu, ju kujtoj se keni të drejtën të kundërshtoni që  
25 të jepni dëshmi për aspekte që mund t'ju inkriminojnë, në bazë

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 të rregullës 151, pika 1, e Rregullores së Procedurës dhe  
2 Provave.

3 Dëshmitar, i kuptuam këto që sapo thashë?

4 DËSHMITARI: Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
6 disa udhëzime praktike.

7 Çdo gjë që thuhet këtu përkthehet nga përkthyesit dhe  
8 regjistrohet. Prandaj është e rëndësishme që të flisni afër  
9 mikrofonave që keni përpara, të flisni ngadalë dhe të flisni  
10 qartë.

11 Duhet të filloni të jepni përgjigje vetëm pasi ta ketë  
12 mbaruar personi që ju ka drejtuar këtë pyetje. Pra, kur ju  
13 bëjnë një pyetje, prisni pesë sekonda përpara se të flisni,  
14 sepse ky pesë sekondëshi i jep mundësi përkthyesve që ta  
15 mbarojnë fjalinë dhe më pas ju mund të filloni me përgjigjen  
16 tuaj. Edhe nuk duhet që të kemi folës që flasin njëherazi  
17 sepse stenografi nuk i merr dot, nuk i regjistron dot në të  
18 njëjtën kohë atë që thonë dy persona. Në rregull?

19 DËSHMITARI: Në rregull.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
21 unë ngre dorën, siç po bëj tani, pushoni së foluri. E bëj këtë  
22 që të mos flasim njëkohësisht.

23 Nëse keni pyetjet apo keni nevojë për ndonjë pushim,  
24 ngrini ju dorën dhe unë do ju jap fjalën.

25 Ndonjëherë mund t'ju kërkojmë të dilni nga salla e gjyqit

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 sepse mund të ketë nevojë të kemi diskutime për përmbajtjen e  
2 pyetjeve që ju drejtojnë.

3 Dhe, në fund, mund t'ju kërkojmë që të bëni shënime në  
4 kompjuter për imazhe që do ju tregojnë në ekran. Do ju  
5 ndihmojë Asistentja e Gjykatës me një shënjes që të bëni  
6 shënimin përkatës.

7 DËSHMITARI: Në rregull.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
9 Dëshmitar, i kuptuat të gjitha këto?

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
12 rregull.

13 Tani sikurse bëjmë me të gjithë dëshmitarët, do ju  
14 kërkojmë të lexoni deklaratën solemne se të thoni të vërtetën  
15 dhe ju kujtoj se është vepër penale të japësh dëshmi të rreme.  
16 E kuptoni këtë?

17 DËSHMITARI: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
19 lutem, lexoni me zë tekstin që keni përpara.

20 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm përpara rëndësinë e dëshmisë  
21 time dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do  
22 të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën  
23 dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
25 Faleminderit. Tani jeni nën betim për të thënë të vërtetën.



Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 9

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 Dhe mund të fillojmë me dëshminë tuaj. Do ia jap fjalën  
2 avokatit që të fillojë.

3 Ju keni katër orë, Avokat, nëse keni nevojë për  
4 ndryshime, ju lutem na njoftoni.

5 Fjala është për ju.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
7 Gjykatëse.

8 DËSHMITARI: W03887

9 Pyetje nga z. Gilissen:

10 Z. GILISSEN: [Përkthim]

11 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Sikurse e dini, unë jam Avokati  
12 i z. Shala. Dhe dua t'ju bëj disa pyetje për aspekte të  
13 ndryshme dhe pas kësaj do t'ju tregoj disa segmente videosh që  
14 ju i njihni dhe do ju bëj disa pyetje për këto video.

15 Pikë së pari, dua të flasim për ju, na jepni disa të  
16 dhëna personale për të shkuarën tuaj.

17 Z. Dëshmitar, a mund të na thoni emrin dhe mbiemrin?

18 PË. Zijadin Hoxha.

19 PY. Faleminderit. A keni nofkë apo a keni patur ndonjë nofkë  
20 në të shkuarën?

21 PË. Jo.

22 PY. Cila është datëlindja juaj dhe vendlindja juaj?

23 PË. 20 qershor 1961, Prishtinë.

24 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, a keni precedent penal apo a  
25 keni pasë precedent penal në të shkuarën?

1 PË. Në të shkuarën e kalume po, po tash nuk kam. Kam qenë  
2 përndryshe i burgosur politik në vitin 1981. I kam mbajtur 9  
3 vjet burg në burgjet e Jugosllavisë.

4 PY. Për çfarë veprash penale ju kanë dënuar?

5 PË. Kam qenë në demonstratat e 1981 faktikisht dhe më kanë  
6 akuzuar si kontrarevolucion.

7 PY. Faleminderit. Ku keni jetuar para luftës në vitin 1998?

8 PË. Në 1998 kam jetuar në Gjermani.

9 PY. Pse u larguat në këto momente, pse shkuat në Gjermani?

10 PË. Në vitin 1993 kanë desh me më arrestu për të dyti  
11 herë UDB jugosllave dhe faktikisht kam ikur nga vendi im kam  
12 dalë në Gjermani, e kam fituar azilin politik e kam fituar në  
13 Gjermani. Dhe në Gjermani kam jetuar.

14 PY. Faleminderit. Pra, Dëshmitar, ju a jeni kyçur në UÇK?

15 PË. Po.

16 PY. A mund të na shpjegoni kur dhe në ç'rrethana jeni kyçur  
17 në UÇK?

18 PË. Po ma së pari, në vitin 1998, faktikisht kam qenë i kyçur  
19 në Fondin Vendlindja Thërret dhe në prill të 1999 kam ardhë në  
20 Shqipëri. Se e lexova dje stenogramin -- pardje e lexova  
21 stenogramin është gabimisht. Nuk kam ardhë faktikisht unë në  
22 maj në Kukës, po kam ardhur në prill, në 22 prill, në 22 ose  
23 23 prill. Është gabimisht data. Është përkthimi a ç'ka a në  
24 pyetje nuk e di. Po unë kam ardhë në prill faktikisht, ajo  
25 shkruan aty unë në maj që kam ardhur.

- 1 PY. Faleminderit. Pra, ju thoni në prill të vitit 1999?
- 2 PË. Diku 22 ose 23 prill 1999.
- 3 PY. Faleminderit. Nëse mund të na jepnit një datë, pra, ose
- 4 periudhën kur jeni kyçur në UÇK dhe rrethanat si jeni kyçur në
- 5 UÇK. A mund të na e shpjegoni që ta kuptojmë edhe ne situatën,
- 6 si u kyçët ju në UÇK dhe për afërsisht kur?
- 7 PË. Po faktikisht unë kam qenë si aktivist i Fondit
- 8 Vendlindja Thërret për mbledhjen e ndihmave në Gjermani. Dhe
- 9 mbas masakrave të njëpasnjëshme që i bëjke okupatori serb në
- 10 popullatën shqiptare në Kosovë faktikisht, kam vendos me ardhë
- 11 me u kyç në UÇK. Dhe kam vendos faktikisht për me hi mbrena.
- 12 Kam ardhë me një shok, kam ardhë prej Gjermanie kam ardhë në
- 13 Tiranë. Kam bujt një natë në Tiranë, pe atyjit e kam pasë
- 14 qëllimin me shku për Kukës dhe me hi mbrena në Kosovë. Por
- 15 fati e ka desh asisoj që jam marrë në Kukës.
- 16 PY. A ju kujtohet emri i atij shokut që ka qenë me ju në ato
- 17 momente?
- 18 PË. Po. Ka qenë Ekrem Ahmeti.
- 19 PY. Faleminderit. Si përfunduat në Kukës ju?
- 20 PË. Po faktikisht, na kemi shku pi Tirane për Kukës me u
- 21 mobilizu në Kukës dhe me hi mbrena në Kosovë se ka qenë si
- 22 pikë grumbullimi aty. Dhe për atë arsye e shku në Kukës.
- 23 PY. A ju kujtohet data që keni mbërritur në Kukës?
- 24 PË. Jo, saktësisht nuk më kujtohet data. Dikun ka qenë 22 ose
- 25 23 prill. Megjithëse, unë deklaratën e parë që e kam dhënë në

1 EULEX aty ish faktikisht më 22-23 maj. Dhe faktikisht unë në  
2 maj kam qenë veç në Kukës në atë kohë. Ish një gabim teknik  
3 apo i përkthyesve nuk e di.

4 PY. Në rregull. Faleminderit. Është shumë e qartë. Sipas jush  
5 sa kohë keni qëndruar në Kukës?

6 PË. Në Kukës kam qëndru dikund deri në 6 apo qershor 1999.

7 PY. Faleminderit. A mund të na thoni pse u larguat nga Kukësi  
8 në këto momente?

9 PË. Po faktikisht unë jam largu pej Kukësit në detyrë pej  
10 komandantit për me ardhë për Gjermani apat për me ble do  
11 pajisje, do ndihma të shpejta dhe dy xhipa që na u nevojitshin  
12 faktikisht dhe kam mbet në Gjermani. Se nuk e kam ditë që  
13 përfundon lufta ato katër-pesë ditë. Më nuk jam kthy poshtë.

14 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Shumë e qartë. Tani do kalojmë  
15 në një temë tjetër.

16 Dëshmitar, kur u kyçët në UÇK në Kukës a kishte ndonjë  
17 proces konkret që duhet të ndiqnit për t'u kyçur në ushtri,  
18 pra, në UÇK, ndonjë hap konkret që duhet të ndërmerrenit?

19 PË. Jo. Diçka të posaçme faktikisht nuk ka pasur. Na kemi  
20 qenë aktivista të Fondit Vendlindja Thërret dhe i kemi pasë  
21 kartelat faktikisht dhe me njëherë jemi lajmëru, te porta jemi  
22 lajmëru. Kemi hi brenda në kazermë dhe jemi kyç menjëherë. Nuk  
23 ka pasë një procedurë të posaçme diçka.

24 PY. Shumë e qartë. S'kishte formalitete, pra, ndonjë  
25 formalitet?

1 PË. Jo, jo.

2 PY. Faleminderit. Shumë faleminderit, Dëshmitar. Po ju çfarë  
3 pune kishit, çfarë detyrash kishit në Kukës?

4 PË. Po na faktikisht me qëllim jemi mobilizu në Kukës me  
5 pritë një ditë ose dy dhe hi mbrenda në front. Por, fati e  
6 deshti asisoj që unë kam mbet në Kukës dhe e kam kry detyrën  
7 si mjeshtër për riparimin e armatimit dhe për furnizim me  
8 armatim.

9 PY. A jeni në gjendje të na shpjegoni kush ua caktoi këtë  
10 punë?

11 PË. Po në një farë mënyre ja kam caktu vetvetes. Atë natë që  
12 kemi mbërri në Kukës, faktikisht, ka qenë goxha vonë ka qenë.  
13 Në nesret në vizitë e sipër të kazermës, në një qoshe të depos  
14 aty, e kam pa një grumbull të madh armatimesh me defekte dhe  
15 kam pyet një komandant e kam pyet a ka mundësi me pruvu me i  
16 riparue. Dhe faktikisht ma ka dhanë lejen për me fillu me  
17 riparu dhe pej atyjit faktikisht e kam kry atë detyrë.

18 PY. Faleminderit. Dhe ju thoni që tha në rregull mund t'i  
19 rregullosh. Kush ishte ky person që të tha okej?

20 PË. Ka qenë komandant Mark Shala.

21 PY. Ju e konsideronit atë si eprorin tuaj?

22 PË. Po, e konsideroj dhe e kam pasë epror faktikisht.

23 PY. Faleminderit. Kush ka qenë i autorizuar të mbante armë në  
24 fabrikën e metalit në Kukës?

25 PË. Po faktikisht, të brezit, armë të vogla, kanë pasë drejtë

1 gati të gjithë me mbajt, ai që ka pasë. Për armë të gjata  
2 faktikisht nuk ka pasë drejtë kurrkush brenda uzinës aty me  
3 mbajt. Përpos roja që ka qenë te dera, aty po. Përndryshe nuk  
4 kemi pasë drejtë me mbajt armë të gjata.

5 PY. Po ju keni pasur armë personale?

6 PË. Jo, personale s'kam pasë.

7 PY. Faleminderit. Gjatë periudhës që përmendët më herët, pra,  
8 prill deri në fillim të qershorit të 1999, keni qëndruar në  
9 Kukës gjatë gjithë kësaj periudhe?

10 PË. Po faktikisht unë Kukës kam qëndru. Po kam lëvizë qysh ka  
11 pasë nevojë faktikisht, pi nevojave ku ka pasë nevojë. Edhe ku  
12 ka pasë armatim me defekte, na kanë ftu dhe kemi shku kemi  
13 riparuar në Krumë, në Cahan ose mvaret pej vendit.

14 PY. Ka kaluar shumë kohë, e kuptoj shumë mirë këtë. Po sipas  
15 jush, a ju kujtohet, pak a shumë, sa kohë keni kaluar në Krumë  
16 apo në Cahan apo në këto vendet tjera që keni shkuar?

17 PË. Ato kanë qenë, faktikisht, kanë qenë vizita njëditore jo  
18 për me ndejt ma shumë. Brenda ditës kemi shku ose e kemi  
19 tërhek armatimin në Kukës e kemi riparue ose në qoftë se ka  
20 pasë armatim pak ose defekte të vogla i kemi riparuar aty për  
21 aty.

22 PY. Në rregull. Besoj se është e qartë. Faleminderit.

23 Dëshmitar, disa prej nesh kanë qenë në fabrikën e metalit  
24 në Kukës, ka disa të tjerë që nuk kanë qenë asnjëherë, ju jeni  
25 në gjendje të na e përshkruani fabrika e metalit në Kukës,

1 ambientin atje, a mund të na e përshkruani?

2 PË. Po mundet me ndodhë që 100 për qind tani nuk muj me jua  
3 përshkru, po për afërsisht po.

4 PY. Ne do ju ndihmojmë dhe do ju tregojmë disa fotografi për  
5 qëllime identifikimi. Fotografitë janë bërë në vitin 2019, që  
6 do të thotë ka ndryshuar shumë gjërat. Se është 20 vjet më  
7 pas. Po do e vlerësonim shumë sikur të na e shpjegonit nëse e  
8 njihni vendin.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Prandaj me lejen e Trupit Gjykues  
10 do të doja që të shfaqej në ekran materiali SPOE40010264,  
11 pastaj 40010559, në faqen 3.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
13 ta vendosni në ekran, Sekretare.

14 Avokat, mund ta pyesni dëshmitarin, si fillim mund ta  
15 pyesim dëshmitarin nëse njeh ndonjë gjë në këtë fotografi.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim]

17 PY. Atëhere, Dëshmitar, a e njihni këtë vend që po shikojmë  
18 në këtë fotografi?

19 PË. Sapo më duket, sapo e njof unë këtë vend faktikisht është  
20 hyrja në uzinë.

21 PY. A ka ndryshuar shumë?

22 PË. Shumë për së tepërmi.

23 PY. A mund të na e përshkruani ju lutem se çfarë ndërtesë po  
24 shohim këtu? A mund të na evidentoni cilat janë këto ndërtesa  
25 që po shohim këtu?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
2 propozoj Avokat Mbrojtës që ju ose t'i japim dëshmitarit një  
3 laps dhe të fillojë t'i shënojë ndërtesat në mënyrë që të jemi  
4 të qartë se për çfarë behet fjalë këtu në sallën e gjyqit.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
7 ftuese e gjyqit, ju lutem a mund t'i jepni dëshmitarit një  
8 laps që ta përdorë?

9 Faleminderit.

10 Mund të vazhdoni, Avokat.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim]

12 PY. Z. Dëshmitar, do të ecim së bashku duke i shënuar këto.

13 Kemi ndërtesën e parë në të majtë, po mund të shikoni këtu

14 janë disa dritare. A e njihni këtë ndërtesë, a e dini se cila

15 ndërtesë është?

16 PË. Po edhe pse nuk po i shoh dyert e hymjes, faktikisht po

17 më duket ndërtesa në anë të majtë është ku ka qenë shtabi.

18 PY. Ju faleminderit shumë. A mund t'i vendosni numrin 1

19 ndërtesës me lapsin?

20 PË. [Shënon]

21 PY. Shumë faleminderit.

22 Kemi dhe një ndërtesë tjetër përballë asaj që e quajmë

23 hyrja, më duket se ka katër dritare apo jo. A e njihni këtë

24 ndërtesë?

25 PË. Kjo ka qenë faktikisht depoja e materialit. Kjo ka qenë



1 depoja kryesore.

2 PY. Faleminderit. Shumë e qartë. Ju lutem a mund t'i vendosni  
3 numrin 2 kësaj ndërtese.

4 PË. [Shënon]

5 PY. Po faleminderit. Tani shikojmë dhe një ndërtesë tjetër  
6 dhe një ndërtesë tjetër në të djathtë. A mund ta identifikoni  
7 këtë ndërtesë?

8 PË. Unë ndërtesën po e identifikoj si ndërtesë, po na qasje  
9 në atë ndërtesë nuk kemi pasë. Asnjëherë në atë ndërtesë  
10 mbrena nuk kam hy.

11 PY. Në rregull. Ju lutem vendosni numrin 3 në këtë ndërtesë.

12 PË. [Shënon]

13 PY. Shumë faleminderit.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Tani mund të kalojmë në një  
15 fotografi tjetër. Kjo është ERN SPOE400710264-40010559, në  
16 faqen 16.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
18 falni që po ju ndërpres, por së pari duhet të ruajmë  
19 fotografinë që kemi dhe t'i jepet një numër prove dhe pastaj  
20 do të vazhdojmë me fotografinë tjetër.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë desha të kursej kohë, por  
22 patjetër.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Faleminderit.

25 Atëhere, znj. Sekretare, ju lutem ruajeni dhe jepini një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 18

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 numër kësaj fotografie.

2 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

3 këshillohen]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga

5 Dëshmitari W3887 me numrin ERN SPOE40010266 do t'i jepet numri

6 i Zyrës Administrative REG00982.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Tani kemi në ekran një fotografi tjetër që numri i së  
10 cilës është përmendur në faqen 15, rreshti 18. A mund ta  
11 nxirrni? E shikoj që e keni gjetur.

12 Z. Avokat, edhe këtë fotografi për qëllime identifikimi.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, patjetër.

14 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë ndërtesë?

15 PË. Po, e nderuar.

16 PY. A ka ndryshuar shumë?

17 PË. Shumë.

18 PY. Duam të dimë se për çfarë përdorej kjo ndërtesë?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
20 kë ndërtesë e kemi fjalën?

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për atë që shikojmë në fotografi.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
23 këtu shikoj nja katër ndërtesa.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëhere mund të jem më preciz.

25 PY. Ndërtesa e madhe që shikojmë që është me dy kate ka disa

1 dritare.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
3 është ndërtesa e dytë në të majtë afër derës ku shohim makinën  
4 e bardhë?

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk desha të flas për derën edhe  
6 hyrjen, por aty duhet të fokusohem.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet  
8 të jeni më specifik. Ju lutem, a mund t'i themi dëshmitarit që  
9 t'i vëre një numër dhe pastaj të vazhdoni me pyetjet tuaja.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim]

11 PY. A e shikoni ndërtesën për të cilën po flasim, ndërtesa e  
12 dytë nga e majta, kur fillon e majta, ju lutem vendosini  
13 numrin 1 kësaj ndërtese që të jemi të sigurt që po flasim për  
14 të njëjtën ndërtesë.

15 PË. [Shënon]

16 PY. Po. Për çfarë përdorej kjo ndërtesë, z. Dëshmitar?

17 PË. Faktikisht këtu ka qenë shtabi i logjistikës. Komanda e  
18 logjistikës faktikisht në përgjithësi.

19 PY. A është e njëjta ndërtesë që e shënuat me numrin 1 në  
20 fotografinë tjetër?

21 PË. Po, e njëjta është.

22 PY. Faleminderit. Është shumë e qartë.

23 PË. Kush i kishte zyrat aty?

24 PË. Po faktikisht në katin e parë kanë nejt shumica kanë nejt  
25 që kanë punu në logjistikë, ushtarët. Në katin e dytë ka qenë

1 komanda e logjistikës, faktikisht ku ka nejt komandant Marku e  
2 komandanta tjerë.

3 PY. Faleminderit. Po ju vetë kishit ndonjë zyrë apo një vend  
4 ku rrinit në këtë ndërtesë?

5 PË. Jo, saktësisht, faktikisht, unë nuk kam pasë zyre fare  
6 aty. Vetëm është një zyre ku kam flejt faktikisht kohë pas  
7 kohe me do koleg tjetër. Se përndryshe zyrën teme nuk kam pasë  
8 aty.

9 PY. Atëhere ku ke fjet në atë ndërtesë, a mundesh me na e  
10 tregu, a është e dukshme këtu, a shihet?

11 PË. Po, shifet faktikisht ku kam vu numrin 1, po kati përdhes  
12 pi fillimit, pi anës së majtë në të djathtë, është dritarja e  
13 tretë.

14 PY. A mund t'i vendosësh numrin 2, të lutem.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
16 qartësi, z. Avokat, dëshmitari tha "Ku kam flejtë herë pas  
17 here".

18 Z. Dëshmitar, sa herë shpesh ke fjet aty?

19 DËSHMITARI: Po shumë shpesh kam flejtë në këtë dhomë  
20 faktikisht, se kjo ka qenë dhoma e një komandanti tjetër ka  
21 qenë. Kanë qenë dhe tre shtrete dhe një tavolinë faktikisht,  
22 po shumicën e rasteve aty kam flejtë me shoqni.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Avokat, keni fjalën.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

2 Gjykatëse.

3 PY. Ndonjëherë keni fjetur në Krumë apo në Cahan apo

4 asnjëherë nuk keni fjet atje?

5 PË. Jo, s'më ka ndodhur, Jo.

6 PY. Në rregull. Atëhere i kthehemi përsëri Kukësit, dritarja

7 me numrin 2 dhe desha të di a keni qenë në gjendje me dëgju

8 zhurma nga dhomat të tjera kur keni fjet atje natën?

9 PË. Jo, nuk ka ndodhë.

10 PY. A keni dëgju ndonjë zhurmë të veçantë natën apo asnjëherë

11 s'keni dëgju?

12 PË. Jo, s'më ka ndodhë me ndëgju ndonjë zhurmë, diçka të

13 posaçme, nuk më ka ndodhë.

14 PY. Pra, ky ishte një vend që kishte shumë lëvizje, kishte

15 shumë transport dhe sipas jush ishte një vend shumë i qetë?

16 PË. Po, faktikisht i qetë ka qenë gjatë natës se gjatë ditës

17 ka pasë qarkullim të njerëzve pa ndërprerje aty, se pa

18 ndërprerje është punue. Pa ndërprerje është furnizu me

19 materiale, kanë ardhë materiale, kanë shku materiale nëpër

20 vijat e frontit. Se kjo logjistikë ka qenë faktikisht. Aty ka

21 qenë qarkullimi tënd ditën pa ndërprerje. Po në mbrëmje

22 faktikisht ka qenë qetësi. Se në mbrëmje zakonisht edhe nuk

23 kemi pasë furnizime. Atëhere aty jemi stacionu edhe kemi

24 pushue. Kemi pasë nevojë edhe për pushim, normal.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Mbrojtës, për sqarim, faqja 19, rreshtat 10 dhe 11, unë nuk  
2 kam dëgjuar asgjë që të thoshte dëshmitari për transporte edhe  
3 kamiona, vetëm ju e përmendët këtë, ju lutem mund të qëndrojmë  
4 te fjalët që thotë dëshmitari?

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Sigurisht. Unë e sugjerova atë  
6 për të qenë i qartë, por megjithatë këtë e bëra vetëm për të  
7 qenë i qartë.

8 PY. Atëhere a ju kujtohet, Dëshmitar, ndonjë zhurmë e veçantë  
9 e posaçme gjatë kohës që keni qenë në Kukës gjatë natës, apo  
10 nuk ju kujtohet?

11 PË. Jo, s'më kujtohet.

12 PY. Faleminderit shumë.

13 Atëhere Dëshmitar, a ka pasur një zyrë mjekësore në këtë  
14 fabrikën e metalit në Kukës?

15 PË. Po, ka qenë një zyrë e vogël faktikisht. Ku kanë ndenjtë  
16 dy vajza apo tri. Nuk e di saktë sesa kanë qenë.

17 PY. Sipas jush, ku ishte kjo dhomë apo kjo zyrë mjekësore, ku  
18 ishte e vendosur ajo?

19 PË. Po ka qenë në katin përdhës faktikisht. Aty dikund te  
20 hymja, në anë të djathtë qaty. Afër hymjes ka qenë.

21 PY. Kemi këtë fotografi në ekran. E shikoni këtu apo nuk  
22 është e mundshme të shihet në këtë foto?

23 PË. Nuk shihet. Nejse me u duk, duket faktikisht, po është në  
24 anën e kundërt është. Jo në këtë pjesë po anën e kundërt të  
25 korridorit është ajo dhomë.

1 PY. Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
3 falni, Mbrojtës. Ju lutem, që ta mbajmë këtë foto dhe të  
4 shkojmë tek fotoja e mëparshme që ta shënojmë në fotografinë e  
5 mëparshme. Besoj që duhet të jetë numri 4. Po ta shënojmë me  
6 aty. Nuk kemi mbaruar akoma me këtë fotografi, do ta ruajmë,  
7 por të shkojmë njëherë te fotografia e mëparshme.

8 Z. Mbrojtës, unë kisha ndërmend t'ju ndërprisja. Mund të  
9 vazhdoni mbarojmë me këtë fotografi apo si dhe pastaj të  
10 shkojmë te fotografia tjetër për t'i vendosë numrin.

11 Ju lutem, vazhdoni.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shikoj në ekran fotografinë ku  
13 kemi numrin 2. Të kalojmë tek fotografia tjetër.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po do  
15 ta bëjmë, do shkojmë tek fotografia tjetër kur të mbarojmë me  
16 këtë.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po unë nuk kam më pyetje në  
18 lidhje me këtë fotografi, kështu që mund të shkojmë tek  
19 tjetra.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
21 Sekretare, a mund ta ruajmë këtë fotografi dhe t'i japim një  
22 numër të Zyrës Administrative?

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga  
24 Dëshmitari W03887 me SPOE40010279, do t'i jepe numri REG00983.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 24

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 Faleminderit, Sekretare.

2 Ju lutem, Mbrojtës, a mund ta përsërisni numrin ERN të  
3 fotografisë që ishte përpara kësaj?

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. SPOE40010264-40010559, faqja  
5 16.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit.

8 Ju lutem Sekretare, a mund të na e nxirrni këtë fotografi  
9 dhe sugjeroj që dëshmitari të vërë numrin 5 sepse nuk është  
10 përdorur ai numër ende, pra, Dëshmitar, a mund të shënoni se  
11 ku ishte zyra mjekësore, qendra mjekësore.

12 DËSHMITARI: Më fal, po as këtë pjesë nuk duket ajo zyrë,  
13 se është ndërtesa faktikisht e hymja, hymja kryesore ku është  
14 te Shtabi i Përgjithshëm, është korridori mbasandaj është në  
15 anën e majtë. Ajo nuk duket në këtë fotografi, nuk duket fare.  
16 Aty janë dy anë faktikisht në anën e djathtë dhe në anën e  
17 majtë ka zyre. Në anën e majtë ka qenë zyra e sanitetit, në  
18 anën e djathtë kanë qenë zyrat e komandantëve tjerë. Nuk duket  
19 as këtu fare nuk duket ajo zyre. Duhet me hy mbrendësi të  
20 korridorit faktikisht për me u vërejtë ajo zyre.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
22 ju kuptoj drejtë kjo zyra e sanitetit - atëherë më ta them  
23 ndryshe. A kishte dritare kjo zyra e sanitetit?

24 DËSHMITARI: A nuk e di. Nuk e di. Për besë nuk e di.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në



1 rregull. Jua treguam këtë fotografi sepse ju thatë që mund ta  
2 kishim parë këtu në këtë foton e parë --

3 DËSHMITARI: Jo, jo.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] --  
5 atë zyrën e sanitetit. Kurse tani jua treguam këtë fotografi  
6 dhe ju po thoni që "nuk shihet as këtu". Do ta shënojmë që nuk  
7 shihet.

8 Znj. Sekretare, mund ta hiqni fotografinë.

9 Z. Mbrojtës, keni fjalën.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Para sesa ta heqim fotografinë, a  
11 mund ta pyesim dëshmitarin.

12 PY. Këtu shikojmë disa dritare. A e dini se kujt i takonin  
13 këto dritare? Kjo dritare që shikojmë në të majtë, kujt i  
14 takon?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Fillojmë me dritaren e parë në të majtë. A e dini se për çfarë  
17 përdorej?

18 PË. Jo, nuk e di. Nuk e di. Nuk e di dhe janë harru gjënat se  
19 24 vjet, 25 vjet faktikisht. Nuk më kujtohet.

20 PY. Po, ju kuptojmë plotësisht. Dhe preferoj që të thoni "Nuk  
21 e di" dhe "Nuk më kujtohet" sesa të bëni hamendje.  
22 Faleminderit shumë.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do të shikojmë të njëjtën provë,  
24 të njëjtën ERN, të shikojmë faqen 15.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 lutem Sekretare, hiqeni këtë dokument.

2           Arsyeja pse këtë po ia tregoni fotografim dëshmitarit,  
3 Mbrojtës?

4           Z. GILISSEN: [Përkthim] Të shikojmë nëse kemi -- t'i  
5 japim një shans tjetër për të parë nëse mund të shikohet  
6 dritarja a mund ta shikojmë atë zyrën e famshme të sanitetit.

7           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
8 lutem, Sekretare, vendosni në ekran foton që kërkon Mbrojtësi.

9           Z. GILISSEN: [Përkthim]  
10 PY. Z. Dëshmitar, a ka një pamje më të mirë këtu, a jeni në  
11 gjendje me identifikim se ku ishte kjo dhomë e vogël, dhoma e  
12 sanitetit?

13 PË. Mundet me qenë tek këto tri dritaret e vogla, po nuk jam  
14 i sigurtë. Nuk muj me thënë me saktësi të plotë. Po mundet me  
15 qenë kjo te hymja faktikisht. Te hymja kryesore, ku është  
16 hymja kryesore e bazës. Po nuk jam 100 për qind i sigurtë.

17           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
18 mund t'i vendosim numrin 5 aty?

19           Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.

20                               [Trupi Gjykes dhe Sekretari i Gjykatës  
21                               këshillohet]

22           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Vazhdoni, Mbrojtës.

24           Z. GILISSEN: [Përkthim]

25 PY. Ju vetë keni shku tek kjo zyrë e sanitetit?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 27

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 PË. Më ka ra rasti një herë kam qenë 5 minuta, dhjetë, jo ma  
2 shumë. Një herë më ka ra rasti.

3 PY. A njihni një person me emrin Time Kadriaaj?

4 PË. Jo, nuk e njoh. Tani e njoh, po atëherë në luftë nuk e  
5 kam njoft. Në luftë nuk e kam njoft.

6 PY. Po, shumë e qartë. faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
8 mund të hiqet fotografia?

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po. Më falni.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka  
11 asgjë për të kërkuar falje.

12 Ju lutem Sekretare, hiqeni këtë fotografi dhe ju lutem  
13 pasi ta keni ruajtur vendosini një numër të Zyrës  
14 Administrative.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga  
16 Dëshmitari W03887 me ERN SPOE40010278 do t'i jepet numri i  
17 Zyrës Administrative REG00984.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
19 të vazhdoni, Mbrojtës.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, a e njihni një person me emrin Safete  
22 Hadërgjonaj.

23 PË. Tash e njoh, a gjatë luftës nuk e kam njoft. Është fytyrë  
24 publike faktikisht.

25 PY. Në rregull. Faleminderit. A e njihni një person me emrin

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 28

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 Ilir Rakaj?

2 PË. Jo, nuk e njof.

3 PY. Në rregull. Faleminderit. Desha të di, z. Dëshmitar, nëse  
4 kishte zyrtarë apo eprorë shqiptarë në fabrikën e metalit në  
5 Kukës?

6 PË. Më duket ka qenë një, po emrin nuk ia di.

7 PY. Po. A e njihni një person me emrin Spiro Butka?

8 PË. Jo, personalisht nuk e njoh.

9 PY. Faleminderit. Ju lutem edhe njëherë faqen 16 të me të  
10 njëjtën ERN.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
12 çfarë qëllimi?

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për identifikim.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
15 lutem, znj. Sekretare, nxirreni fotografinë.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim]

17 PY. Është e njëjta fotografi, z. Dëshmitar, por unë desha ta  
18 di nëse mund të identifikoni ndërtesën në të djathtë, atë me  
19 ngjyrë të përhimët?

20 PË. Po.

21 PY. A mund të na tregoni diçka më shumë për këtë ndërtesë?

22 PË. Po faktikisht në këtë ndërtesë ka qenë kuzhina, ka qenë  
23 një pjesë e mekanikës edhe ka qenë një dhomë e fjetjes.

24 PY. A mund të vendosni numra për këto vendet e ndryshme që  
25 përmendët? Për shembull, kuzhina, hyrja për në kuzhinë?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
2 të përdorim numrin 4, numrin 4 akoma s'e kemi përdorur.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

4 DËSHMITARI: [Shënon]

5 Z. GILISSEN: [Përkthim]

6 PY. Përmendët dhe një vend tjetër, mbasi kjo dera tjetër në  
7 të djathtë. A ju kujtohet, çfarë mund të ketë qenë ky vendi?

8 PË. Kjo qenë faktikisht për riparimin e automjeteve.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
10 lutem vendosni numrin 6.

11 DËSHMITARI: [Shënon]

12 Z. GILISSEN: [Përkthim]

13 PY. Më duket se shohim dhe një dritare, ky që ka disa hekura  
14 jashtë, ky është i njëjti vend apo është një vend tjetër në  
15 ndërtesë?

16 PË. Jo, është e njëjta ndërtesë faktikisht, po kjo më duket  
17 lidhet me uzinë, lidhet me pjesën tjetër lidhet. Sa e mbaj  
18 mend, mos gabofsha.

19 PY. Që të jemi të sigurt, është e mira që të vendosim numrin  
20 7 vendit që sapo përmendët.

21 PË. [Shënon]

22 PY. Shumë e qartë. Kaq më nevojitej kjo fotografi.

23 Përfundova. Ta ruajmë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 [Mikrofoni çaktivizuar].

1 Faleminderit.

2 Dëshmitar, shoh që doni të thoni diçka? Dhe unë kam një  
3 pyetje për ju. Po fillimisht na thoni çfarë doni të thoni?

4 DËSHMITARI: Po është këtu në qoshe para numrit 4  
5 faktikisht është një dhomë e fjetjes, ka qenë një dhomë e  
6 fjetjes ka qenë goxha e madhe ka qenë aty. Bash në qoshe, dy  
7 ndërtesat në qoshe, dy ndërtesave ka pasë hymjen.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
9 t'i vendosni numrin 8 që ta kuptojmë për të cilin qoshe e keni  
10 fjalën?

11 DËSHMITARI: [Shënon]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit. Po shoh në të djathtë, në fakt, këtë pyetje  
14 kishim dhe ne në Panel. Mund ta ruajmë fotografinë tani.

15 Sekretare, ruajeni fotografinë. Dhe ju lutem t'i  
16 vendosini numrin e Zyrës Administrative.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet që bëri  
18 Dëshmitari 03887 në materialin me numër SPOE0010279 marrin  
19 numrin e Zyrës Administrative REG00985.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
21 Faleminderit.

22 Avokat, kam nevojë t'i bëj një pyetje sqaruese  
23 dëshmitarit për ndërtesë me ngjyrë të përhimët.

24 Dëshmitar, ajo ndërtesa me ngjyrë të përhimët, ku keni  
25 vendosur dhe numrat 8, 4, 6 dhe 7, a ka qenë njëkatëshe, me

1 një kat si ndërtesë?

2 PË. Njëkatëshe ka qenë vetëm që ka qenë naltësia më e madhe,  
3 se njëkatëshe ka qenë faktikisht. Sa e di unë. Mos gabofsha.  
4 Mos gabofsha një katëshe ka qenë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit, Dëshmitar. Po ia jap sërish fjalën Avokatit.

7 Z. Gilissen, fjala është për ju.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju faleminderit.

9 Do të doja të shohim të njëjtin material me të njëjtin  
10 numër ERN por të shkojmë në faqen 13.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim]

13 PY. Z. Dëshmitar, a i njihni ndërtesat në këtë fotografi?

14 PË. Po.

15 PY. Po. A mund të na identifikoni ndonjë vend apo vende dhe  
16 të na shpjegoni dhe ne çfarë po shohim këtu në fotografi?

17 PË. Po faktikisht në anën e majtë janë këto ndërtesat që i  
18 ceka para me numra. A përballë është ndërtesa faktikisht ku ka  
19 qenë uzina, ku ka qenë materiale, faktikisht depoja kryesore  
20 ku ka qenë.

21 PY. Faleminderit. Që të jemi të sigurt a e kemi kuptuar, kemi  
22 një derë aty tek pema. Kjo është hyrja për tek ajo depoja që  
23 thatë?

24 PË. Jo, nuk besoj. Dera duhet me qenë më në mes ka ana e  
25 djathtë. Këto dyer s'po më kujtohen. Nuk po më kujtohen këto

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 32

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 dyer.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Propozoj ta shënojmë këtë, hyrje po i themi, me numrin 9 që ta  
4 kemi të qartë për çfarë po flasim.

5 DËSHMITARI: Në rregull.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit, Dëshmitar. Dhe po ashtu për të qenë të qartë,  
8 ndërtesën në të majtë, a e kuptova unë saktë që kjo ishte  
9 ndërtesa që shënove pak më përpara me ato numrat 4, 6, 7, 8,  
10 apo jo, që shënove te fotografia më përpara?

11 DËSHMITARI: Po, ajo është.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Atëherë a mund t'i vendosni një 10, numrin 10.

14 DËSHMITARI: [Shënon]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit. Që të jetë e qartë, sa herë të na duhet të  
17 rishikojmë transkriptin në të ardhmen ta kemi të qartë për  
18 çfarë kemi folur.

19 Avokat, fjala është sërish për ju.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Të shohim dritaren në të djathtë të derës. Pjesë e depos  
22 kanë qenë këto dritaret apo nuk e dini se çfarë janë?

23 PË. Kjo ka qenë pjesë e depos, faktikisht.

24 PY. Shumë mirë. A mund t'i vendosni numrin 11?

25 PË. [Shënon]



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 33

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj se mund ta ruajmë

2 dokumentin tani.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Sekretare, ruajeni dokumentin dhe jepini numrin e Zyrës

6 Administrative.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

8 shënimet që i bëri Dëshmitari 03887 tek materiali me numër

9 SPOE40010276 marrin numrin REG00986.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit.

12 Avokat, fjala është sërish për ju.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

14 Dua që të shfaqet në ekran i njëjti material por në faqen

15 12.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Vazhdoni.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, a njihni këtë ndërtesë?

20 PË. Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

22 mund të jeni më konkret?

23 DËSHMITARI: Po kjo është --

24 Z. GILISSEN: [Përkthim]

25 PY. Që ta kuptojmë çfarë është kjo ndërtesë. Të kemi një ide,

1 ju na dhatë disa shpjegime më përpara, po ne duam të jemi të  
2 sigurt që ta kuptojmë ne tamam se çfarë është.

3 PË. Kjo është depoja kryesore faktikisht edhe është edhe  
4 hymja kryesore në depo, është pjesa e djathtë. Kjo ka qenë  
5 depo komplet faktikisht.

6 PY. Faleminderit. A mund t'i vendosni numrin 12, besoj,  
7 derës?

8 PË. [Shënon]

9 PY. Faleminderit. Dhe ju lutem vendosni 13 te ajo që thoni ju  
10 ndërtesa kryesore, depoja kryesore.

11 PË. [Shënon]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam  
13 nevojë të bëj një pyetje sqaruese, Avokat.

14 Dëshmitar, kur thoni "depoja kryesore", është si ndërtesa  
15 e përhimët dhe ajo ndërtesa ngjitur me ngjyrë ndryshku, apo  
16 jo, me këtë murin si me tulla portokalli, ngjyrë tulle?

17 DËSHMITARI: Jo, faktikisht, kjo ka qenë komplet, ka qenë  
18 vetëm depo, ka qenë prej fillimit deri në mbarim, faktikisht,  
19 ka qenë me material ushtarak. Pej fillimit deri në mbarim ka  
20 qenë vetëm material ushtarak ka pasë këtu.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Atëherë që ta kuptoj unë. Unë dua të di ku mbaron depoja?

23 DËSHMITARI: Po tash nuk po di në anën e djathtë sa  
24 vazhdon ende fotografia, për qatë arsye nuk po e di  
25 saktësisht, se vazhdon ende pej numrit 12 ku e kam vu vazhdon

1 ende në anën e djathtë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
3 rregull. Dëshmitar, do përpigem të jem më e qartë. Ndërtesa,  
4 ajo pjesë e ndërtesës mbi numrin 12 dhe ajo depo është, ajo që  
5 është mbi numrin 12?

6 DËSHMITARI: Po ajo depo a komplet faktikisht. Këtu ka  
7 qenë hymja kryesore, ka qenë te 12 ka qenë hymja kryesore. Po  
8 ka vazhdu mbasandaj depoja ka vazhdu edhe në anën e djathtë  
9 edhe në anën e majtë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
11 e qartë.

12 Avokat, fjala është sërish për ju.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, a jeni në gjendje të na shpjegoni ku ka qenë  
15 vendi ku punonit ju?

16 PË. Po faktikisht ka qenë në brendësi të kësaj depos. E kam  
17 pasë një tavolinë faktikisht që nuk duket në brendësi.

18 Brendësia nuk duket për momentin.

19 PY. Faleminderit. Në cilën pjesë? Në pjesën e përhimët apo  
20 këtë ngjyrë ndryshku?

21 PË. Te numri 12 faktikisht në anën e djathtë, në anën e  
22 djathtë duhet me shku për me shku te tavolina jeme e punës.

23 PY. Domethënë, nuk jemi në gjendje ta shohim vendin këtu?

24 PË. Ah jo.

25 PY. Ku keni pasë skrivarinë?

1 PË. Jo, nuk duket. Pi jashtit nuk duket.

2 PY. Ju zakonisht ecnit atje, domethënë - fal - atje punonit  
3 atje zakonisht apo punonit gjithmonë?

4 PË. Po mvaret. Kokë pas kohe kur kam pasë punë më pak  
5 faktikisht kam punu mbrenda kam punë. Kur kam pasë me riparu  
6 armatim pak ma shumë atëherë kam dalë në oborr të kazermës dhe  
7 aty i kam riparu. I kam thirr edhe do ushtarë tjerë si ndihmë  
8 edhe më kanë ndihmue. A përndryshe shumicën e kohës kam punu  
9 mbrenda.

10 PY. Faleminderit. Shumë e qartë.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shkojmë në një fotografi tjetër.  
12 Në të njëjtin dokument por në faqen 11.

13 Po fillimisht mos duhet të ruajmë fotografinë që shënuam?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
15 Sekretare, nuk e kemi ruajtur këtë fotografi? Atëherë nëse nuk  
16 është ruajtur, ju lutem ruajeni dhe jepini numrin e Zyrës  
17 Administrative.

18 Avokat, është ora 11.00 pa dhjetë, po jua them këtë vetëm  
19 për të qenë -- ta keni parasysh kohën.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
21 shënimet që bëri Dëshmitari 03887 në materialin me numër  
22 SPOE40010275 marrin numrin REG00987.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Faleminderit.

25 Avokat, fjala është sërish për ju.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Tani do të doja të shihnim një  
2 fotografi tjetër me të njëjtën ERN por në faqen 11.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
4 Sekretare, ju lutem vendoseni materialin në ekran.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Dëshmitar, a mund të na shpjegoni çfarë po shohim në këtë  
7 fotografi?

8 PË. Po është faktikisht është depoja kryesore është. Kjo  
9 vazhdon pij fillimit deri në mbarim faktikisht ka qenë depo.  
10 Ka qenë faktikisht e mbushur me ushqime, me veshmbathje, me  
11 uniforma, me të gjitha faktikisht kanë qenë getu. Se është  
12 furnizu, është logjistika kryesore për furnizimin e frontit në  
13 Kosovë.

14 PY. Shumë e qartë. A mund të vendosni tek dera të njëjtin  
15 numër që vendosët te fotografia tjetër. Më duket se ishte  
16 numri 8, po s'jam i sigurtë, apo 12. 12.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
18 shoh që tek shënimet e mia është numri 12.

19 Ju lutem, Dëshmitar, vendosi numrin 12.

20 DËSHMITARI: [Shënon]

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. A është e mundur të na tregoni vendin ku keni punuar?

23 Sipas jush, ku ka qenë tavolina juaj?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
25 vendosni numrin 13 -- 14. Ju lutem 14.

1 DËSHMITARI: Po faktikisht tavolina jeme e punës ka qenë  
2 në mbrendësi të kësaj depos. Edhe nuk duket në këtë fotografi  
3 pe jashtit nuk duket. Se ka qenun në brendësi ka qenë.  
4 Përafërsisht muj me vu numrin, po saktësisht nuk e di se është  
5 mbrenda në ndërtesë faktikisht. Mbrenda ndërtesës.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim]

7 PY. Është interesante që ta dimë, po mund ta shënonim  
8 sidoqoftë. Faleminderit.

9 PË. Cilin numër, më falni, me ia vu?

10 PY. Më duket se numri 14.

11 PË. [Shënon]

12 PY. Faleminderit.

13 Kur hyje tek dera që kemi vendosur numrin 12, pra, është  
14 mes dy ndërtesave këtu, desha të pyes, a ka pasur, mes këtyre  
15 dy ndërtesave a ka pasur ndarje mes ndërtesës me ngjyrë të  
16 përhimët dhe a ka pasur ndonjë derë të brendshme që ndante  
17 këto dy pjesë të ndërtesës?

18 PË. Jo. Jo s'ka pasë. Jo, jo, nuk ka pasë. Jo. Ka qenë  
19 hapësirë, komplet hapësirë faktikisht. Zbrazë ka qenë pa  
20 ndërprerje.

21 PY. Në rregull. Shumë e qartë. Faleminderit.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj se është dhe momenti i mirë  
23 për të filluar pushimin tani, sepse dua të trajtoj një temë  
24 tjetër dhe mbase është më e përshtatshme që ta filloj këtë  
25 temë të re pas pushimit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 39

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Sekretare, ju lutem ruajeni këtë fotografi dhe vendosni  
4 numrin e Zyrës Administrative sërish.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet që bëri  
6 Dëshmitari 03887 në materialin SPOE40010274 marrin numrin e  
7 Zyrës Administrative REG00988.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Dëshmitar, tani do bëjmë një pushim gjysëm ore. Do ju  
11 shoqërojë Asistentja jashtë sallës së gjyqit dhe do të shihemi  
12 bashkë në orën 11.30. Faleminderit.

13 DËSHMITARI: Ju faleminderit.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
16 rregull. Takohemi për gjysmë ore.

17 Seanca ndërpritet këtu.

18 --- Pauza fillon në orën 10.55

19 --- Seanca rifillon në orën 11.30

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
21 se erdhët përsëri. Shikoj një ndryshim të vogël në përbërjen e  
22 ekipit të Prokurorisë.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

24 Prokurorja e Specializuar nuk është e pranishme.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Mbrojtja duket se është me të njëjtën përbërje.

3 Atëherë në rregull, të vazhdojmë me dëshminë e z. Zijadin  
4 Hoxha.

5 Znj. Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallën e  
6 gjyqit.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
9 se erdhe, z. Dëshmitar.

10 DËSHMITARI: Përshëndetje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A më  
12 dëgjoni mirë?

13 DËSHMITARI: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
15 Shala, a e dëgjoni mirë dëshmitarin dhe përkthimin?

16 I AKUZUARI: Po, ndëgjoj shumë mirë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
18 rregull. Atëherë z. Mbrojtës, Avokat Mbrojtës, keni fjalën për  
19 të vazhduar me pyetjet kryesore.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbasi kemi parë edhe një herë  
21 materialin, deshëm që të bëjmë pyetje edhe për një fotografi  
22 tjetër përpara se sa të vazhdojmë me një dokument tjetër.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
24 rregull. Atëherë, për qëllime identifikimi dhe kjo?

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Atëherë, jepjani Sekretarisë numrin.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është e njëjta numër prove ERN,  
4 por faqja ndryshon. Është faqja 19. Qëllimi është që të kemi  
5 pamje të plotë të oborrit. Faleminderit.

6 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë vend dhe këtë ndërtesë që  
7 shohim në fotografi?

8 PË. Po, e njof. Por ka ndryshu shumë, ka ndryshu faktikisht.

9 PY. A mundeni të na shpjegoni çdo, për çdo pjesë të ndërtesës  
10 që po shohim se çfarë dini për të, çfarë informacioni mund të  
11 na jepni për çdo pjesë të saj?

12 PË. Po faktikisht, ana e majtë e jemja, janë depot kryesore,  
13 faktikisht, në anën e djathtë kjo nuk e di çka ka qenë,  
14 faktikisht, se nuk kemi pasë qasje në atë objekt. Aty ka pasë  
15 çelësat vetëm pronari i objektit, i ka pasë çelësat. Edhe se  
16 s'kam pasë rast kështu zbrazët me e pa këtë oborr asnjherë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Propozoj që t'i vejmë numrin 15 ndërtesës që sapo u përshkrua  
19 nga dëshmitari.

20 Ju lutem, dëshmitar, vendoseni numrin.

21 DËSHMITARI: Ndërtesën në anën e majtë apo në anën e  
22 djathtë?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
24 përshkruat një ndërtesë që nuk keni qenë kurrë aty, pronari i  
25 objektit e kishte çelësat. Atë ndërtesë, ju lutem, shënojeni

1 me numrin 15.

2 DËSHMITARI: [Shënon]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

6 PY. Z. Dëshmitar, në qoftë se vazhdojmë me këtë ndërtesë, që  
7 e shënuat me numrin 15, shkojmë tek një ndërtesë që ka disa si  
8 ngjyra. Duket si e kaltër, apo ngjyrë gri. A e njihni këtë  
9 vend?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
11 nuk e kam të qartë, Mbrojtës, se për cilën ndërtesë e keni  
12 fjalën?

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është e vetmja ku shohim pak  
14 ngjyra, një lloj ngjyre. Në mes të fotografisë. Janë dy vende,  
15 Ku duket si pak e kaltër e lehtë, e çelët, ose e kaltër e  
16 bardhë, pastaj janë dy pjesë të tjera me tulla.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
18 shoh një mur të bardhë, për atë e keni fjalën?

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, duket sikur është mur i  
20 bardhë.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem a mund ta nxjerrim  
22 dëshmitarin nga salla e gjyqit për një minutë?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Asistente, ju lutem mund ta shoqëroni dëshmitarin për një  
25 moment jashtë?

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Prokuror, keni fjalën.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Pyetja për një ndërtesë në këtë

5 fotografi që nuk ekziston mund të jetë çorientuese. Kolegu

6 bëri disa pyetje sepse kjo fotografi nuk përfaqëson atë që

7 ishte atëherë në kohën kur ka qenë dëshmitari, dhe ndoshta

8 dëshmitari mund të besojë se kështu dukej në vitin 1999, por

9 kjo nuk është faktikisht ashtu.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,

11 unë e kuptoj z. Prokuror, por mos ki frikë për këtë sepse vetë

12 dëshmitari tha që ka ndryshuar shumë nga çfarë ka qenë më

13 parë.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, e vërtetë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,

16 mendova se kjo do të ishte pyetja juaj, dhe do t'ju jepja

17 mundësinë të përgjigjeshit vërejtjeve të Prokurorit. Unë

18 mendova se çfarë, do ta pyesnit më vonë se si ka ndryshuar,

19 pse ka ndryshuar kaq shumë. Sepse ai foli në përgjithësi për

20 të gjithë kompleksin. Ndoshta do të ishte kjo një pyetje që

21 duhet bërë dhe pyetje mjaft e hapur.

22 Dhe sugjerimi juaj, z. Prokuror, dhe pastaj besoj që do

23 të dëgjojmë se çfarë do të thotë dëshmitari, dhe mund ta

24 pyesim hapur atë nëse mund të komentojë për të. Unë enkas e

25 thashë "muret", sepse nuk dua të jap asnjë indikacion në

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 lidhje me këto ndërtesa për dëshmitarin.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kjo pjesë e ndërtesës është  
3 shumë e rëndësishme për çështjen gjyqësore, dhe nuk duhet të  
4 kemi asnjë lloj konfuzioni për këtë. Dëshmitari tha dy ose tre  
5 herë kur tha për këtë pjesë që i gjithë kompleksi ka ndryshuar  
6 shumë, por ai po komentonte për pjesë të tjera. Dhe, po t'i  
7 bëhet atij një vërejtje specifike që t'i thuhet që këtu nuk  
8 përfaqëson siç ka qenë kompleksin në vitin 1999.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Faleminderit.

11 Mbrojtës, keni fjalën.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë e kuptoj plotësisht kolegun  
13 tim, por do të ishte gabim, mendoj unë, që të jepnim këtë lloj  
14 informacioni, se mund t'i jepte sugjerim dëshmitarit. Për  
15 shembull, mund t'ju bëj një pyetje shumë të hapur, a e njihni,  
16 siç është këtu, dhe do të shikojmë se si do të përgjigjet ai.  
17 Pastaj, pyetjet vijuese do të jenë nëse, çfarë ndryshimesh  
18 janë bërë.

19 Por mendoj që është pak delikate kjo puna e pyetjeve, ta  
20 pyesësh, a ka ndryshuar apo jo. Do ta shikojmë. Qëllimi i  
21 kësaj fotografie është për të marrë informacion sepse kemi  
22 disa ndërtesa të cilat, për të cilat nuk kemi marrë asnjë  
23 informacion përpara, ose kemi shumë pak informacion nga më  
24 parë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 Prokuror, ju u çuat në këmbë.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, vetëm desha të them që nuk  
3 kishte transkript, por tani është në rregull.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Atëherë, propozojmë që të vazhdojmë kështu.

6 Së pari, duhet të bëhet një pyetje, pyetja çfarë ka  
7 ndryshuar për sa i përket ambienteve që shihen në këtë  
8 fotografi.

9 Z. Prokurori, për sa i përket informacionit për ndërtesa  
10 të veçanta, e shikoj shqetësimin që keni, por do t'ju jepet  
11 mundësia gjatë pyetjeve tuaja që t'i bëni pyetje dëshmitarit  
12 për materiale që mendoni që janë të rëndësishme sipas jush, në  
13 mënyrë që të shohim se çfarë ka ai për të thënë për këto. Por  
14 për momentin nuk është koha për ta detyruar Mbrojtjen që të  
15 bëjë pyetje siç mendojmë ne.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
17 po shikoj tani që janë çuar në këmbë dy avokatë.

18 Z. Aouini, atëherë ju i pari keni fjalën.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Për këtë pikë. Mirëmëngjes të  
20 gjithë njëherë. Nuk është se nuk duam, por nuk kemi asnjë lloj  
21 prove që të na jetë dhënë se kur ka ndryshuar kjo ndërtesë? Sa  
22 herë ka ndryshuar dhe kur, në çfarë kohe është?

23 Ne kemi fotografi të 2011, por ne nuk e dimë se çfarë  
24 pamje ka pasur në 1999. Nuk mund t'i themi që a dukej kjo  
25 njësoj në 1999, sepse nuk e dimë as vetë dhe Prokurori nuk ka

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 sjellë prova për gjendjen faktike të ndërtesës në vitin 1999.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Mbrojtës. Në këtë fazë nuk duhet të bëjmë

4 deklarata, deklaratat janë për më vonë. Por, ajo që po

5 përpiqesha të them unë është që i takon Mbrojtjes të vazhdojë

6 siç e mendon ajo me pyetjet. Dhe pastaj çfarë rrjedh nga ajo,

7 janë arsye të ndryshme, por unë nuk do t'ju detyroj që ta bëni

8 pyetjen në atë mënyrë siç u tha.

9 Z. Prokuror.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Shumë shpejt, e nderuar

11 Gjykatëse. Kemi pasur dy dëshmitarë që e kanë njohur ndërtesën

12 siç ishte në 1999, që ishte WD0909 [Sipas përkthimit] dhe

13 pastaj ai që mbaron me -- domethënë kemi një lloj sqarimi,

14 desha të sqaroj pak që kjo ekziston, është dhënë si provë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e

16 lexoj dhe një herë transkriptin se nuk është e qartë për mua

17 se çfarë u tha.

18 Për momentin do ta lë këtu, është e qartë se si do të

19 vazhdojmë më tej.

20 Znj. Sekretare mund t'i thoni Asistentes që të sjellë

21 dëshmitarin përsëri brenda.

22 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Mirë se erdhët përsëri, Dëshmitar.

1 Do t'ia jap edhe një herë fjalën Mbrojtësit që të  
2 vazhdojë me pyetjet.

3 Keni fjalën, Mbrojtës.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
5 Gjykatëse.

6 PY. Atëherë, Dëshmitar, i kthehemi përsëri kësaj fotografie.  
7 Shohim këtu disa fotografi. Është ajo që keni identifikuar me  
8 numër 15 në të djathtë. Dhe përballë shohim disa ndërtesa.  
9 Është ajo që ka një ngjyrë si të bardhë, pastaj shohim një të  
10 ngjashme me tulla dhe pastaj është në fund aty edhe një  
11 ndërtesë me tulla.

12 A kanë ndryshuar këto ndërtesa? Kanë ndryshuar shumë,  
13 kanë ndryshuar pak? A mund të na jepni një lloj informacioni  
14 në lidhje me këtë?

15 PË. Nuk di çka të them. Faktikisht, këtë pjesë nuk e njof se  
16 është problemi se këtu ku është vinçi tani për momentin, kanë  
17 qenë dy ose tre kamiona, kanë qenë kamiona me defekte. Ata nuk  
18 kanë lëvizë fare faktikisht. Në atë pjesë nuk e di çka ka  
19 pasë, tek ka pasë, për vete nuk di, nuk muj me thanë asgjë.  
20 Nuk muj, s'më kujtohet, ene atë ndërtesa nuk më kujtohen. Qe  
21 ajo pjesë aty.

22 PY. Faleminderit. A mund t'i vendosni numrin 16 vendin ku  
23 ishin kamionat në oborr?

24 PË. [Shënon]

25 PY. Po, faleminderit. Është shumë e qartë. Dhe është edhe kjo

1 ndërtesa e gjatë në fund të oborrit shohim lart disa dritare.

2 A e dini se për çfarë përdorej kjo ndërtesë?

3 PË. Jo, nuk e di. Nuk e di. Nuk kam qenë në atë pjesë

4 asnjëherë, s'kam qenë faktikisht.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë

6 nuk e kam të qartë se çfarë po diskutojmë.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më falni. në të majtën kemi

8 ndërtesën që është identifikuar më parë si depo. Tani kemi në

9 të djathtë me numër 15, një ndërtesë që nuk e dimë se çfarë

10 është. Sepse dëshmitari na tha që nuk ka qenë aty, nuk ka pasë

11 akses aty. Dhe pastaj kemi përballë dy lloj shtresash. A mund

12 ta them kështu? Një me ngjyrë të bardhë dhe pas asaj një

13 ndërtesë tjetër të gjatë. Dhe lart shihen dritare, dhe çfarë

14 ishte kjo ndërtesë me të cilën mbyllet oborri? Nuk e di a jam

15 i qartë, preciz sa duhet.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua

17 t'ju ndjek, t'ju përcjell, por nuk e kam të qartë. Do ta lexoj

18 dhe një herë çfarë thuhet në transkript.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ndërtesa mbrapa.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

21 t'jua përshkruaj. Në të majtë shoh pemët e gjelbra, dhe në atë

22 qoshe shohim një mur që është me tulla. Me ngjyrë të përhimët

23 dhe pak si të kuqe. Në katin e dytë.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kjo është ndërtesa që është

25 mbrapa. E cila mbyll oborrin. Unë desha të di se çfarë ishte



1 kjo ndërtesë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Atëherë, nuk po diskutoni muret e bardha apo si të kuqërreme.

4 Do t'i quaj 1, 2, 3, 4. Por ndërtesën mbas atyne mureve.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë në qoftë se

6 s'jam shumë i qartë me këto.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

8 ka nevojë të kërkoni falje. Pra do të them që është ndërtesa

9 dykatëshe mu në fund të fotografisë.

10 Dëshmitar, për të qenë të sigurt se për cilën ndërtesë po

11 flasim a mund t'i vendosni numrin 17 ndërtesës në fund të

12 oborrit që përbëhet, nuk e di, a është me dy kate apo jo, por

13 është, poshtë është ngjyrë e përhimët kurse lart janë tullat

14 pak si të kuqërreme dhe pastaj ka një si lloj konstruksioni me

15 dru.

16 DËSHMITARI: [Shënon]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

18 Shoh në të djathtë, Prokuroria mendon që është e qartë

19 dhe Mbrojtja mendon që është e qartë?

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, është e qartë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

22 rregull.

23 Mund të vazhdoni.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Pra, numri 17 është vendosur në

25 dritaret e ndërtesës që është pas mureve me ngjyrën e bardhë.

1 PY. Unë desha t'ju pyes, Dëshmitar, për çfarë përdorej ajo  
2 ndërtesë?

3 PË. Nuk e di. S'kam pasë qasje asnjherë në atë ndërtesë. Nuk  
4 e di. S'kam qenë asnjherë në atë ndërtesë.

5 PY. Shumë faleminderit. Është shumë e qartë.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëherë mund të ruhet fotografia  
7 sepse nuk kemi më pyetje të tjera në lidhje me të.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
9 dua të hyj në shumë detaje në lidhje me këtë fotografi. Por,  
10 vetëm për sqarim, z. Dëshmitar, aty ku vendosët numrin 16, sa  
11 kamiona ishin aty, qëndronin aty?

12 DËSHMITARI: Nuk e di përafërsisht tre apo katër, kanë  
13 qenë me defekte. Se s'kanë mujtë me i riparuar, faktikisht, edhe  
14 veç kanë ndejtë aty pa ndërprerje, aty kanë ndejtë. Aty kanë  
15 qenë të parkumë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
17 rregull. Atëherë ju po dëshmoni -- ta shoh dhe një herë atë që  
18 sapo thatë, ta shoh në transkript.

19 A ju kam kuptuar drejt, ju lutem më korrigjoni në qoftë  
20 se e kam gabim. Ju thatë që këto kamionat me defekte e  
21 pengonin pamjen tuaj, domethënë nuk ju lejonin me pa? Unë e  
22 thashë me fjalët e mia, por a po thoni kështu, që ata kamionë  
23 nuk lejonin me pa ma tutje?

24 DËSHMITARI: Po, korrekt.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 51

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 rregull. E shënuam këtë, faleminderit.

2 Znj. Sekretare, ju lutem ruajeni këtë fotografi. Dhe  
3 jepini një numër të Zyrës Administrative.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga  
5 dëshmitari W03887 me SPOE40010282, do t'i jepet numri  
6 REG00989.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Faleminderit.

9 Tashmë u bë.

10 Mbrojtës, keni fjalën.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Atëherë, Dëshmitar. Ju na thatë se gjërat kanë ndryshuar  
13 shumë aty në fabrikën e metalit në Kukës. A mund të na  
14 shpjegoni se çfarë ka ndryshuar? Kur thoni "ka ndryshu shumë",  
15 a mund të na e shpjegoni pak për të qenë të sigurt që ju e  
16 kuptoni? Domethënë, që e kuptojmë ne informacionin që na e  
17 keni dhënë ju?

18 PË. Por faktikisht, ka ndryshu shumë se koha ka bo të vetën.  
19 Dikund e ka prishë fasadën, dikund është, ndonjë ditare është  
20 e thyme, qato gjana po mendoj se jo për diçka tjetër. Se ai  
21 objekti si objekt ka mbetë asisoj, por është shkatërru në  
22 njifarë mënyre, për q'atë arsye ka ndryshue. Qysh ka qenë  
23 atëherë faktikisht nuk është tash. Qysh ka qenë para 24  
24 viteve.

25 PY. Po, domethënë kjo është e vërtetë për të gjitha vendet në

1 fabrikën e metalit në Kukës apo vetëm disa prej tyre? Apo  
2 është një reflektim i përgjithshëm i juaj në lidhje me atë  
3 vend?

4 PË. Jo, në përgjithësi faktikisht ka ndryshime, në  
5 përgjithësi. Nuk është vetëm një objekt si ka ndryshu diçka  
6 pak, por në përgjithësi, faktikisht, unë po e shoh shtabin,  
7 faktikisht, ku ka qenë shtabi është i shkatërrumë komplet.  
8 Tjetër pamje ka pasë, krejt tjetër atmosferë ka qenë. Është  
9 krejt diçka tjetër, tash është diçka tjetër.

10 PY. Në rregull. Faleminderit. Tani do të kaloj te një temë  
11 tjetër sepse nuk dua të harxhojmë kohë.

12 Z. Dëshmitar, a e njihni një person me emrin Bislim  
13 Zyrapit?

14 PË. Po, e kam pasë komandant, e kam pasë.

15 PY. Pra ky person ishte në fabrikën e metalit në Kukës në  
16 vitin 1999?

17 PË. Po.

18 PY. Po. Faleminderit.

19 PË. Faktikisht nuk ka qenë pa ndërprerje, por kohë pas kohe  
20 ka qenë aty. Pa ndërprerje nuk ka qenë në Kukës, por kohë pas  
21 kohe po. Se ka qenë komandanti kryesor i operacionit Shigjeta.  
22 Ai e ka udhëheqë aksionin komplet.

23 PY. Po, shumë e qartë. Unë madje këtë pyetje do ju bëja në  
24 vijim, edhe tani ju iu përgjigjët asaj.

25 Tani pyetja tjetër është, a e njihni një person me emrin

1 Jakup Krasniqi?

2 PË. Po, e njoh, bile shumë moti. Qysh prej viteve 1987, 1998,  
3 faktikisht, kam qenun në burg, në burg së bashku kemi qenë me  
4 Jakup Krasniqin. Ai ka qenë politikisht i dënumë që ashtu kam  
5 qenë dhe unë, dikund tri vite kemi qenë së bashku në burg të  
6 Novi Sadit.

7 PY. Po, faleminderit. Shumë e qartë. A e ke pa këtë person,  
8 Jakup Krasniqin, në Kukës në vitin 1999?

9 PË. Jo, asnjherë nuk e kam pa.

10 PY. Je i sigurt, asnjëherë? As edhe një herë?

11 PË. 100 për qind jam i sigurt që asnjherë nuk e kam pa.

12 PY. Faleminderit. A e njihni një person me emrin Bedri Azemi?

13 PË. Po, e njof Bedri Azemin. Jemi njoftu aty në kazermë, jemi  
14 njoftu. Edhe sot asaj dite kemi shoqëri së bashku.

15 PY. Pra, ka qenë në fabrikën e metalit në Kukës në vitin  
16 1999. A e dini çfarë roli kishte?

17 PË. Po, ka qenë aty faktikisht, por rolin saktësisht nuk e  
18 di, a e ka pasë, edhe ai ka qenë në logjistikë se na në  
19 logjistikë kemi qenë të gjithë, por a ka pasë depon e  
20 materialit ushqimor, apo të uniformave, nuk e di cilën resor e  
21 ka pasë. Nuk e di, s'jam i sigurt. Po dhe Bedrija ka qenë aty,  
22 pa ndërprerje ka qenë aty. Me Bedrinë faktikisht e kemi nda  
23 edhe një shtrat e kemi nda, se në atë zyrë ku kam flejtë unë  
24 kanë qenë vetëm tre shtretëni. A katër vetë kemi flejtë aty, ka  
25 qenë një sfungjer përfundit shtratit. Kur ka shku Bedrija ma

1 herët me flejtë, e ka nxjerrë sfungjerin ka flejtë në  
2 sfungjer. Ma ka lanë shtratin mue, por kur kam shkue unë ma  
3 herët me flejtë, e kam nxjerrë sfungjerin. Unë kam flejtë në  
4 sfungjer, ai ka flejtë në shtrat.

5 Kështu e njoh shumë mirë, e njoh. Familjarisht e njoh.

6 PY. Faleminderit, shumë e qartë.

7 A e njihni një person me emrin Sabit Geci?

8 PË. Sabit Gecin e kam njoftë pas lufte, gjatë luftës nuk e  
9 kam njoftë Sabit Gecin. Pas lufte po. Kam pasë rast jam taku  
10 dy-tri herë me të. Por gjatë luftës nuk kam pasë rast as me e  
11 taku, as me e njoftë si emën.

12 PY. Pra, nuk e dini, nuk e dini nëse e keni parë, nuk e dini  
13 a e keni parë në fabrikën e metalit në Kukës -- çfarë po thoni  
14 në lidhje me këtë, nuk e keni parë apo jo?

15 PË. Jo, jo. jo, jo. Nuk e kam pa kurrë, S'e kam pa. Pas lufte  
16 po, pas lufte e kam takue. Pas lufte. Dikund në vitet 2000.  
17 Ama gjatë luftës, në atë periudhë nuk e kam taku asnjherë, as  
18 në fabrikën e uzinës, as kurrkund.

19 PY. Faleminderit. Po një person me emrin Xhemshit Krasniqi a  
20 e njihni?

21 PË. Veç një sekondë. Si figurë po, mbas lufte faktikisht kam  
22 dëgjue që është dënuë. Që ka qenë aty. Se me e njoftë  
23 personalisht nuk e njof.

24 PY. Faleminderit. Po një person Fadil Hoxha?

25 PË. Po. Po, e kam njoftë edhe e njof.

1 PY. E ke parë ndonjëherë këtë person në fabrikën e metalit në

2 Kukës në 1999?

3 PË. Po, Fadili aty ka qëndru faktikisht.

4 PY. E din çfarë pozicioni kishte, çfarë pozite kishte ai?

5 PË. Saktësisht nuk e di, më duket ka qenë, komandant i

6 policisë ushtarake ka qenë. Por nuk jam i saktë.

7 PY. Faleminderit. Po një person Ruzhdi Saramati e njihni?

8 PË. Jo, atëherë nuk e kam taku asnjëherë. Tash e njof, mbas

9 lufte, e njof faktikisht. A në atë kohë, nuk e kam taku

10 asnjëherë.

11 PY. Faleminderit. Po një person Sali Saramati, e njihni?

12 PË. Jo, nuk e kam njof, as tash nuk e njof faktikisht. Sali

13 Saramati ka ra dëshmor.

14 PY. Dini gjë çfarë i ndodhi, dini gjë në lidhje me këtë

15 person, çfarë i ndodhi?

16 PË. Faktikisht, është vra në frontet e luftës, në dyluftim,

17 faktikisht, me forcat serbe është vra. Është dëshmor i kombit.

18 PY. A njihni një person me emrin Silver Makaja [fonetikisht],

19 ju kërkoj ndjesë për emrin, për shqiptimin, nuk jam i sigurt.

20 PË. Selver Maçkaj, po mendon?

21 PY. Kërkojmë ndjesë, ju kërkojmë ndjesë për shqiptimin.

22 PË. Selver Maçkaj faktikisht është dëshmor i kombit. Edhe ai

23 është vra, në Gorozhup është vra, nga forcat serbe. Edhe është

24 varrosë në varrezat e Kukësit, është varros ma së pari.

25 PY. A njihni një person me emrin Shpend - nuk jemi të sigurt

1 a po e shqiptojmë siç duhet, Shpend Berisha?

2 PË. Është e njëjta faktikisht, edhe ky është dëshmor. Është  
3 vra të njëjtën ditë me Selver Maçkën. Këta të gjithë janë  
4 dëshmorë të kombit.

5 PY. A e njihni dikë me emrin Ilir Ukmataj?

6 PË. Jo, s'paskam dëgju asnjihere.

7 PY. Po Abdurrahman Gerdellaj?

8 PË. Abdurrahman Gerdellaj është dëshmor i kombit, është të  
9 njëjtën ditë, faktikisht, është vra me Selverin dhe me këta të  
10 tjerët.

11 PY. Faleminderit. Po një person Shefki Abdullahu?

12 PË. Po, e njof.

13 PY. Mund të na thoni ndonjë gjë në lidhje me këtë person?

14 PË. Po, faktikisht edhe Shefkiu ka qenë në uzinë, aty ka  
15 qenë. Por çfarë grade ka qenë, nuk e di. Nuk e di çfarë pune  
16 ka kry, nuk e di.

17 PY. A e njihni një person me emrin Gani Saramati?

18 PË. Gani Saramati faktikisht edhe ky është dëshmor i kombit.  
19 Edhe ky është vra në Gorozhup. Është plagu faktikisht në  
20 Gorozhup edhe ka vdekun në Tiranë.

21 PY. A njihni një person me emrin Ismet Thaçi?

22 PË. Po, e njoh.

23 PY. E keni parë ndonjëherë këtë person në uzinën e Kukësit,  
24 në 1999?

25 PË. Po, edhe ky ka qëndru në uzinën e Kukësit, faktikisht.



1 PY. Keni ndonjë informacion që mund ta ndani me ne për këtë  
2 person?

3 PË. Po faktikisht prej Tirane na kemi shku katër vetë, kemi  
4 shku me makinë tonën private. Ka qenë Ekrem Ahmeti, unë, Ismet  
5 Thaçi edhe një Dukagjin Morina. Na katër kemi qenë faktikisht  
6 që kemi shku së bashku për Kukës prej Tirane. Edhe faktikisht  
7 edhe Ismeti ka vepru në qatë pjesë. Çfarë detyre ka pasë, nuk  
8 e di.

9 PY. Në rregull. A njihni një person me emrin Bedri Halimi?

10 PË. Kam dëgju mbas lufte, se atëherë nuk e kam njoftë si  
11 emën.

12 PY. A e dini nëse ka qenë në Kukës gjatë luftës ky person?

13 PË. Nuk di, nuk muj me të thanë ndonjë informatë të sigurt,  
14 nuk muj unë me të dhanë ndonji informatë. Nuk e di.

15 PY. Pa problem, faleminderit. Më mirë kështu.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë  
17 private, Gjykatëse?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pse  
19 doni të kalojmë në seancë private? Na e thoni në momentin që  
20 do kalojmë në seancë private.

21 Sekretare, të kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

Dëshmitari: W03887 (Seancë private)

Faqe 58

Pyetje nga z. Gilissen

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Avokat, fjala është për ju.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Ju kërkoj ndjesë  
3 për këtë incident të vogël. E kuptoj situatën.

4 PY. [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 PY. A e njihni z. Pjetër Shala, mund të më thoni?

7 PË. Jo, nuk e njof edhe kurrë në jetën time s'e kam takue.

8 PY. A e keni parë në ndonjë fotografi, a në televizor? Tani e  
9 dini kush është Pjetër Shala?

10 PË. Po tani e di faktikisht se jam në gjyq, jam dëshmitar për  
11 të, përpara as nuk e kam njoftë, as nuk e taku kurrë në jetën  
12 time. Unë nuk e di edhe Prokuroria për çfarë arsye më ka marrë  
13 në pyetje për një person që nuk e kam njoftë, as nuk e njof.

14 PY. E kuptoni, e kuptoni tamam tani pse e bëra këtë pyetje.

15 A keni njohur një person apo ndokënd që kishte nofkën  
16 Ujku?

17 PË. Jo, s'kam dëgju kurrë.

18 PY. Faleminderit.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj se tani mund të shohim  
20 videon, kam mbaruar me këtë pjesë të pyetjeve.

21 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Ishit shumë i qartë.

22 Tani dua të shohim disa pjesë të videos gjatë qëndrimit  
23 tuaj në uzinën e Kukësit në 1999. Ju, a i keni inçizu disa  
24 video aje?

25 PË. Po, i kam inçizu, faktikisht vorrimet e dëshmorëve.

1 PY. Po, Dëshmitar. Në përgjithësi, çfarë keni inçizuar në  
2 1999, në Kukës? Vetëm ceremonitë e varrimit, apo keni inçizu  
3 edhe ndonjë gjë tjetër?

4 PË. Faktikisht, 99 për qind janë vetëm ceremonitë e varrimit.  
5 Është vetëm një pjesë dikund dhjetë minutëshe që është një  
6 ndenje mbrenda në zyrë përndryshe 99 për qind janë vetëm  
7 vorrime.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Avokat, do të ishte e dobishme, në përgjithësi, që ta sqaronit  
10 qëllimin e këtyre videove dhe sa herë që të shohim një video.  
11 Që ta sqaroni, për çfarë qëllimi.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Keni shumë të drejtë. Unë do jua  
13 shpjegoj.

14 PY. Dëshmitar, do ju tregojmë disa segmente të këtyre  
15 videove, të disa videove, dhe çdo herë do ju kërkojmë të  
16 konfirmoni se e keni inçizuar ju atë, kur e keni inçizuar, dhe  
17 ku e keni inçizuar. Pra për secilën nga pjesët e videos që do  
18 ju tregojmë. Flasim për videot që keni inçizuar ju vetë, që të  
19 jemi të sigurt, të jemi të qartë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
21 ne duam të dimë pse do t'i diskutoni këto me dëshmitarin që ta  
22 kuptojmë ne qëllimin pse doni ta diskutoni?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më besoni, këtë pyetje kam edhe  
24 unë. Si fillim, Dëshmitar pse i keni inçizuar këto videot, të  
25 këtyre dëshmorëve?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
2 jo. Po ju pyes ju si ekip i Mbrojtjes, pse doni ju t'i  
3 diskutoni këto me dëshmitarin? Kjo është, ky është thelbi i  
4 pyetjes time.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj se këto video mund të na  
6 japin informacion për periudhën kohore, periudhën e saktë  
7 kohore që ne na duhet dhe do ju duhet edhe ju kur të merrni  
8 parasysh të gjitha elementet që kemi mbledhur ne. Sepse mund  
9 të lidhet me disa informacione që kanë shpjeguar personat e  
10 tjerë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Prokuror, fjala është për ju.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju kërkoi ndjesë për  
14 ndërprerjen, nëse fillojmë diskutime për arsyet mund të jenë  
15 pak orientuese, sugjestionuese për dëshmitarin. Ne këtë  
16 diskutim mund ta bëjmë, por kolegu i nderuar le të japë  
17 shpjegimet pa praninë e dëshmitarit. Ky është propozimi ynë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Doni  
19 të shtoni më gjë tani?

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Pikë së pari po ju them për  
21 qëllime identifikimi.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Avokat, do flasim për këtë çështje çdo herë që do të  
24 diskutojmë një video. Që ta sqarojmë arsyen, duhet sqaruar  
25 arsyeja pse do shikojmë një segment të caktuar të videos.

1 Tani mund të vazhdoni me pyetjet tuaja.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, a keni pasur kamera ju për t'i inçizuar këto  
4 video edhe si e gjetët këtë kameran?

5 PË. Po, faktikisht, kamerën e kam pasë edhe e kam marrë me  
6 vete prej Gjermanie, e kam marrë me vete. Ka qenë kamerë  
7 personale, ka qenë.

8 PY. A ju duhej leje për të inçizuar ato që keni inçizuar në  
9 ato momente?

10 PË. Jo, por lejen nuk m'u ka nevojitë, por pak ma gjerësisht  
11 ta shpjegoj çështjen e kamerës.

12 Faktikisht kamerën e kam marrë se na kemi qenë aktivista  
13 të Fondit Vendlindja Thërret. Edhe në atë kohë ka pasë  
14 dezinformata tepër të mëdhaja që po dezertojnë ushtarët, se  
15 nuk kanë çka me hangër, nuk kanë çka me pi, dhe qeso sendesh.  
16 Edhe kam marrë kamerën me vete me inçizue edhe për me i dërgu,  
17 faktikisht, në qendrën e Fondit Vendlindja Thërret që nuk janë  
18 të vërteta ato sende. Për q'atë arsye faktikisht e kam marrë  
19 kamerën me vete.

20 Në një farë mënyre e kam pasë si detyrë, e kam pasë edhe  
21 me shku me inçizu. Por masanej luftën sendet, krejt dikan  
22 tjetër edhe janë vetëm ato inçizimet të dëshmorëve kurrgjë  
23 tjetër.

24 PY. Faleminderit. Kur u larguat nga Kukësi, e morët kameran  
25 me vete?

1 PË. Jo, nuk e kam marrë kamerën me vete. Vetëm kasetat i kam  
2 marrë me vete, kamerën jo. E kam lanë aty.

3 PY. I keni ende videot në zotërimin -- i keni ende këto  
4 videot, këto kasetat?

5 PË. Jo, nuk i kam, faktikisht, se m'u kanë shkatërru përpos  
6 që kanë qenun në Facebook që i kam qitë. Që kanë qenë,  
7 faktikisht, përndryshe nuk kam origjinal të tyre, nuk kam. M'u  
8 ka shkatërrue. Nuk kam ditë me i rujtë edhe m'u kanë  
9 shkatërru.

10 PY. A mund të na thoni se në çfarë kushtesh u shkatërruan?

11 PË. Në 2008, faktikisht, ka qenë se kasetat i kam pasë te  
12 shtëpia, por në 2008 ka pasë ka ra shi shumë, faktikisht, edhe  
13 na i ka pasë marrë shtëpijat, na i ka pasë marrë shiu. Ujti na  
14 i ka pasë marrë, përmbi një metër e diçka ka qenë uji nëpër  
15 dhoma, edhe ku i kam pasë kasetat komplet m'u kanë shkatërrue.

16 PY. Pra, i kishit ruajtur përpara këto regjistrimet si ka  
17 mundësi që ekzistojnë tani këto inçizime?

18 PË. Po aty këto janë inçizime faktikisht vetëm në Facebook që  
19 kanë mbetë. As unë nuk kam qasje ma, në q'atë Facebook  
20 faktikisht që kam qenë ma qe prej kur më ka marrë Prokuroria  
21 që më ka marrë në pyetje ma nuk kam qasje në atë Facebook ma.  
22 Me telefon timin s'mund i hapi ato inçizime fare. Për çfarë  
23 arsye, unë nuk e di.

24 PY. Po, pse i keni hedhë këto imazhe online ju?

25 PË. Po një herë kam pritë faktikisht që po formohet muzeu i

1 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbas çlirimit, edhe me i çu me  
2 i dorëzu kasetat. Kur e pashë që po vonohet tepër koha,  
3 faktikisht, edhe m'i lypshin, edhe m'i kërkojshin, familjet e  
4 dëshmorëve m'i kërkojshin inçizimet, atëherë i kam hudhë në  
5 Facebook. I kam qitë publike, se ato sekrete nuk kanë qenë  
6 asnjherë. Ato kanë qenë publike.

7 PY. A keni, a i keni ndryshuar ndonjëherë këto videot,  
8 domethënë i keni edituar më saktë ndonjëherë këto video?

9 PË. Jo, nuk ka fare ndërhyrje në ato inçizime s'ka fare. Qysh  
10 i kam inçizu faktikisht atëherë në 1999 asisoj janë edhe sot.

11 Kush mundet me i shiqu, kush s'mundet me i shiqu. Unë për  
12 vete në telefon temin në Facebook nuk muj me i shique, se m'u  
13 ka bllokue ai Facebook komplet, m'u ka bllokue.

14 PY. Faleminderit. Shumë e qartë.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me lejen tuaj, do ju shpjegoj  
16 edhe arsyen pse, duam të shohim disa segmente të videos së  
17 parë. Duam të tregojmë disa segmente --

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta  
19 shoqërojmë dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit dhe na e  
20 shpjegoni arsyen.

21 Dëshmitar, duhet të dilni përsëri një moment nga salla  
22 dhe do ju kthejmë prapë në sallën e gjyqit.

23 DËSHMITARI: Në rregull.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]



*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 Avokat, na jepni arsyen pse doni të shfaqim këtë segment të  
2 videos.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

4 Këto video janë incizuar, siç tha dhe dëshmitari, disa,  
5 gjatë disa ceremonive mortore. Datat janë shumë të rëndësishme  
6 aktualisht sepse disa nga dëshmitarët e Prokurorisë kanë dhënë  
7 informacione për periudhat kohore, kush ka qenë i pranishëm,  
8 kush është, kush janë personat. Dhe ne, për herë të parë ne  
9 mund vërtet të sqarojmë për çfarë po flasim. Mund të shohim  
10 vendin, përpara se të shkatërrohej ndërtesa, para se të  
11 shkatërrohej uzina e metalit dhe për herë të parë nuk do  
12 shohim vetëm uzinën e metalit, se e keni parë disa herë, por  
13 do shikojmë edhe lëvizjet, për herë të parë do të shohim kush  
14 ka qenë, kush kanë qenë të pranishëm në disa ngjarje të  
15 rëndësishme. Të paktën disa janë shumë të rëndësishme sepse  
16 këto ceremoni mortore kanë qenë, për një periudhë triditore,  
17 ka zgjatur tri ditë. Mund të identifikojmë vendin, pra, si  
18 fillim, periudhën kohore, personat që kanë qenë aty, dhe mund  
19 të marrim shumë informacion nga kjo.

20 Nuk jemi shumë të sigurt se cilin segment duam të shohim,  
21 se duam të zgjedhim segmentin më të përshtatshëm të videos.  
22 Dhe ne do kemi zgjedhur të tregojmë disa pjesë për të kuptuar  
23 një herë kontekstin çfarë ka ndodhur në këtë ceremoni mortore.  
24 Por, në ato pjesë që identifikojmë disa persona. Të shikojmë  
25 fytyrat e disa personave. Edhe t'i themi dëshmitarit, t'i

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 kërkojmë dëshmitarit të na thotë emrat e personave që mund të  
2 shohim në video.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
4 kuptoj, e kuptoj çfarë po përpiqeni të thoni, por ne kemi  
5 video edhe të vendeve të tjera që keni propozuar ju që nuk  
6 bëjnë pjesë në arsyetimin që sapo na dhatë, nuk mund të jenë  
7 pjesë e arsyetimit që sapo na dhatë.

8 Tani ju doni të tregoni cilën pjesë të videos, Avokat?

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ne duam që për videon e parë do  
10 jap edhe numrin përkatës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
12 na e jepni numrin edhe minutazhin, sepse unë kam përpara  
13 parashtrimin e protokolluar në lidhje me këtë kur keni  
14 evidentuar segmentet e ndryshme të videove që doni që të  
15 shfaqen.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, për të parën duam të shohim  
17 videon 07513-01 [Sipas përkthimit], duam të shohim 0751301  
18 [Sipas përkthimit] nga minuta 0 deri tek sekonda 24, 24  
19 sekondëshin e parë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
21 kuptoj që ka, e kuptoj, ka relevancë kjo, kështu që këtë mund  
22 ta shfaqim, këtë video.

23 Në rregull, silleni dëshmitarin sërish në sallë.

24 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

1 se u kthyet, Dëshmitar.

2 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

3 Mbrojtës, keni përsëri fjalën. Sa për t'ju thënë  
4 fillimisht, nëse dalin aty persona që duhen identifikuar, keni  
5 parasysh që jemi në seancë publike, dhe që ndoshta do të duhet  
6 të futemi në seancë private.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, e di, e kam parasysh këtë.

8 Faleminderit për kujtesën, sidoqoftë.

9 Atëherë, znj. Sekretare ju lutem a mund të shfaqet video  
10 në ekran? Të shikojmë këtë inçizim nga 00 deri në sekondën e  
11 24.

12 [Luhet videoincizimi]

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

14 PY. Dëshmitar, a i njihni këto pamje?

15 PË. Po.

16 PY. Po, atëherë a mund të na konfirmoni se ju e keni inçizu  
17 këtë pjesë të videos?

18 PË. Po, unë e kam inçizu.

19 PY. A ju kujtohet data se kur është bërë inçizimi?

20 PË. Data saktësisht s'më kujtohet, por ka qenë dikund 30 apo  
21 31 maj, 31 maj më duket. Nuk jam i sigurt, por 31 maj.

22 PY. Ëhë, në rregull. Atëherë pse, cila është arsyeja që u  
23 kujtohet kjo datë mbas kaq kohësh?

24 PË. Po faktikisht këto janë fakte që nuk harrohen kurrë  
25 përjetë, nuk harrohen. Ky është kamioni që janë tërhyerë të

1 plagosurit, edhe të vramët në Gorozhup. Me këtë kamion  
2 faktikisht i kanë pru në Kukës, te spitali i Kukësit i kanë  
3 lanë të plagosurit edhe të vdekurit, edhe e kanë pru kamionin  
4 e kanë parku te uzina. Këto janë faktikisht inçizime që  
5 ngjesin përjetë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
7 procesverbalin, a mund të na jepni edhe vitin? Unë e di vitin,  
8 por vetëm që ta kemi në procesverbal, cili vit ka qenë?

9 DËSHMITARI: Është viti 1999.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim]

11 PY. Atëherë, Dëshmitar, kamioni që po shohim në ekran është  
12 në uzinën mekanike në Kukës? A e kuptumë drejt?

13 PË. Po.

14 PY. Faleminderit. Mendoj që e kemi informacionin për të kuptu  
15 se çka shohim aty.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dhe tani dua që të shohim në  
17 ekran pjesën e dytë, ekstraktin e dytë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni  
19 çaktivizuar]

20 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dy  
22 vërejtje desha të bëj.

23 E para, për Dëshmitarin. E di që është shumë brengosëse  
24 për ju që t'i shikoni këto pamje, dhe nëse keni nevojë për  
25 pushim, ju lutem më thoni. Sepse po ju tregojmë këto pamje dhe

1 e kuptoj që janë brengosëse për ju.

2 DËSHMITARI: Në rregull, dhe faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe,  
4 ne kemi një pyetje tani Mbrojtës në lidhje me pamjet që sapo  
5 pamë, dhe dëshiroj që t'ia bëj tani këtë pyetje dëshmitarit,  
6 sepse nëse e bëjmë në fund kur na vjen radha neve si Gjykatës,  
7 atëherë do të duam, do të duhet ta shfaqim përsëri këtë video.

8 Ku është parku ky kamion? Sapo pamë pamjet. Ku ishte  
9 parku ky kamion?

10 DËSHMITARI: Faktikisht është i parkum, domethënë, në  
11 oborrin e uzinës. Në kazermën e logjistikës, përndryshe.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur  
13 thoni kazerma e logjistikës, për cilën ndërtesë e keni fjalën  
14 kur thoni "kazerma e logjistikës"?

15 PË. Po faktikisht është oborr të kazermës aty. Aty para  
16 shtabit, faktikisht, para ndërtesës së shtabit aty është e  
17 parkume.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e  
19 kam krejtësisht të qartë ende. Do ta shohim edhe një herë.

20 Sekretare, ju lutem, edhe një herë.

21 [Luhet videoincizimi]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
23 mund të ndalohet këtu.

24 Domethënë, pjesa e përparme e kamionëve, nga e kishin  
25 drejtimin?

1 DËSHMITARI: Faktikisht prej hymjes, prej hymjes kur të  
2 hysh mbrenda në oborrin e kazermës, e ka pasë motorin e ka  
3 pasë kah depoja kryesore.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
5 ta hiqni, Sekretare, më mirë mos ta kemi në ekran.

6 Ajo që e quani juve pra "depoja kryesore", pra, motori  
7 ishte në drejtim, me fytyrë, si të thuash, nga depoja  
8 kryesore. Domethënë depoja ku ke punu ti?

9 DËSHMITARI: Po, po. Ajo është.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
11 mund të na sqaroni ku ishin kamionët e prishun, ata me  
12 difekte, në krahasim me këtë kamion që sapo e pamë tash?

13 DËSHMITARI: Faktikisht, në krahasim me këtë kamionin që e  
14 pamë tash në anën e djathtë janë kamionat e prishur.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
16 rregull. Për momentin e lëmë këtu. Faleminderit, dëshmitar.  
17 Mbrojtës, keni fjalën përsëri.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

19 Nuk kam më pyetje në lidhje me këtë pjesë të parë të  
20 videos, por ka një video të dytë që dua ta shfaqim në ekran.  
21 Është faktikisht me të njëjtin ERN 075138-01, desha që të  
22 shikojmë nga minuta 13, më falni 3, 3 minuta e 11 sekonda deri  
23 në 3 minuta e 28 sekonda. Diçka rreth 15 sekonda gjithsej  
24 është.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 Atëherë, ta nxjerrim edhe një herë dëshmitarin jashtë, dhe  
2 juve të na jepni më shumë sqarim në lidhje me këtë video.

3 Z. Dëshmitar, do të diskutojmë këtë pjesë dhe ju lutem  
4 dilni pak jashtë sa ta diskutojmë.

5 DËSHMITARI: Në rregull.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Mbrojtës, keni fjalën për të na shpjeguar se pse duhet ta  
9 shikojmë këtë pjesë.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është identifikuar personat që  
11 janë, mund t'i shikojmë në pamje dhe mendoj që është shumë  
12 interesante që të tregojmë cilësinë e trajnimeve të UÇK-së në  
13 Kukës. Kjo është vetëm disa sekonda, por mund të shikoni këta  
14 ushtarë, apo luftëtarë të ardhshëm, mënyrën sesi veprojnë me  
15 armët e tyre. Sesi zbatojnë urdhrat dhe është me interes që të  
16 shohim cilësinë në këtë fazë të anëtarëve të UÇK-së.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
18 Prokuror, keni fjalën.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, me respektin që -- okej  
20 është me shumë interes, por nuk e di a ka lidhje, a është  
21 relevante për këtë çështje. Kaq kisha si parashtrim. Ne  
22 mendojmë nuk ka lidhje.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
24 ishte e nënkuptuar në parashtrimin tuaj se çfarë mendoni.

25 Mbrojtës, për sa i përket identifikimit nuk ka nevojë që

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 të jepni prova të mëtejshme. Për sa i përket cilësisë së  
2 trajnimeve, ka diçka që doni të thoni më tej në lidhje me këtë  
3 pikë?

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk është evidente të japësh  
5 diçka si provë, për mua është shumë e qartë. Ne tani po flasim  
6 disa javë ose disa muaj në, kemi disa muaj që flasim për  
7 fabrikën e metalit në Kukës, dhe kemi diskutuar çfarë ishte.  
8 Ishte burg, a ishte qendër trajnimi, njerëzit që punonin atje,  
9 që bënë punë të logjistikës, dhe besoj që është shumë me  
10 interes për ju sepse ju duhet të gjykoni çështjen që ta keni  
11 këtë informacion, janë vetëm pak sekonda ku do të shikoni këta  
12 njerëz që mbërrijnë, që marrin uniformat, i kanë marrë  
13 uniformat dhe çfarë cilësie trajnimi merrnin aty.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
15 Atëherë, do t'i shikojmë, por mendoj jemi aty në kufi në prag  
16 të relevancës, por në qoftë se ju keni zgjedhur të bëjmë këtë,  
17 atëherë do ta bëjmë.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund t'ju drejtohem,  
19 Gjykatësve? Prandaj edhe e kam prerë këtë pjesën kaq shkurt  
20 sepse e kam bërë këtë segment shumë të shkurtër sepse s'ka  
21 nevojë për më tepër.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
23 rregull, do të vazhdojmë me këtë.

24 Ju lutem, mund të vijë dëshmitari përsëri brenda.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
2 se erdhët përsëri, dhe faleminderit që keni durim me ne. Na  
3 duhet ta bëjmë edhe disa herë të tjera të njëjtën gjë. E  
4 shikoj që buzëqeshni. Besoj që e kuptoni që është diçka që  
5 duhet ta bëjmë për momentin.

6 Atëherë, Mbrojtës, keni fjalën domethënë.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
8 Gjykatëse.

9 Atëherë, ju lutem, Sekretare, a mund jepet pjesa që  
10 lidhet me faqen e transkriptit 075138-01-TR-ET, në faqen 1 në  
11 versionin anglisht. Dhe në shqipe është ERN 075138-01-TR-AT.  
12 Nga 3 minuta e 11 sekonda, deri në 3 minuta 28 sekonda.  
13 Faleminderit.

14 [Luhet videoincizimi]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Faleminderit.

17 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Gjykatës  
18 këshillohen]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
20 dëgjohej mirë kështu që dhe nuk mund të përkthehet. Shikoj që  
21 po tundni kokën, po pohoni, Mbrojtës. Domethënë, është e  
22 mjaftueshme për ju që të shikojmë pamjet pa përkthim?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk ka nevojë për përkthim.  
24 Mendoj pyetja ime nuk ka të bëjë me fjalët që thuhet aty.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull. Atëherë, mund të vazhdoni me pyetjet.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. A mund të na shpjegoni se çfarë pamë këtu?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A të

5 fillojmë njëherë me autentikimin pastaj, dhe se kur është

6 inçizuar, kur, ku, dhe pastaj të vazhdojmë me përmbajtjen?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë mendoja se mund ta shpjegonte

8 dëshmitari, por më mirë të pyesim.

9 PY. Z. Dëshmitar, ju e keni inçizuar, e keni inçizuar ju këtë

10 pamje, me kamerën tuaj?

11 PË. Po, unë e kam iniçizu.

12 PY. Po, dhe a ju kujtohet kur i keni marrë këto pamje?

13 PË. Po më kujtohet faktikisht ka qenë 31 maji, ka qenë. Këta

14 janë policia ushtarake. Se më 31 faktikisht kanë ra dëshmorët

15 e parë, kanë ra, në Gorozhup, dhe kanë qenë i caktumë varrimi

16 më 1 qershor. Atëherë, policia ushtarake kanë qenë pa përvojë,

17 se na qysh dhjetë vjet faktikisht prej viteve të 1990, deri

18 vitin 1999, kemi qenë në aparteid të Serbisë në një farë

19 mënyre, edhe as nuk kemi shërby shërbim ushtarak, as kurrgjë

20 hiç, nuk kemi pasë përvojë me armë, edhe me kësoj ceremoni

21 mortore. Atëherë policët ushtarakë i kemi marrë edhe i kemi

22 qitë te Drini i bardhë për me u ushtru për ceremoninë mortore

23 të tre dëshmorëve të parë që kanë ra në Gorozhup.

24 PY. Po. Atëherë, ku janë këta njerëz? Janë afër uzinës

25 mekanike?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Bëni  
2 pyetjet hapur ju lutem.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim]

4 PY. Ku e keni inçizu këtë pamje?

5 PË. Kjo është faktikisht afër Drinit të Bardhë, dikund 2  
6 kilometra prej uzine, në drejtim të Krumës.

7 PY. Po. A është e mundshme të identifikoni personin që po i  
8 jep urdhra të tjerëve?

9 PË. Më duket që ka qenë Latif Fejzullahi ka qenë dhe Fadil  
10 Hoxha. Ata të dy kanë qenë.

11 PY. Faleminderit.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Tani mendoj që e kam marrë  
13 informacionin që kërkoja, kështu që mund të shohim një pamje  
14 tjetër, me lejen tuaj sigurisht.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit, Mbrojtës.

17 Mund ta hiqni këtë pamje.

18 Mbrojtës, kemi dhjetë minuta deri në orën 13.00, shpresoj  
19 që të bëjmë edhe një video tjetër përpara se sa të bëjmë  
20 pushimin e drekës.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ta shikojmë ekstraktin tjetër,  
22 inçizimin tjetër. Numri ERN është i njëjtë, ERN 075138-01, nga  
23 minuta 6:19, deri në 7 e 27 sekonda.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

25 mund të dalë dëshmitari jashtë?

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 Dëshmitar, edhe një herë do ta diskutojmë këtë inçizim.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Mbrojtës, ju lutem a mund të na sqaroni se pse është e

5 nevojshme të tregohet kjo pamje?

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Duhet të kuptojmë kohën midis

7 elementeve të ndryshme që po shikojmë, sepse kuptuam për

8 personat që vdiqën në spital në Kukës. Do shohim numrin e

9 arkivoleve, dhe është shumë e rëndësishme për të parë kohën se

10 kur janë bërë varrimet e ndryshme dhe për të bërë

11 identifikimin e personave që u varrosën.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

13 mua nuk është e qartë pse duhet ta shikojmë, morgun, spitalin,

14 dhe të shikojmë -- nuk e shikoj edhe çfarë relevance ka koha.

15 Për momentin nuk e kuptoj, por mund të më jepni shpjegime, nuk

16 arrij ta shikoj se pse po i qasemi në këtë mënyrë.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Duam t'ju tregojmë kohën e kaluar

18 midis elementeve, sepse duket që këto video janë pjesë të

19 shumta, shumë pjesë bashkë, dhe dëshmitari do të jetë në

20 gjendje që të na thotë kohët, se kur janë bërë inçizimet ose

21 dhe kur kanë ndodhur ngjarjet, dhe të na ndihmojë ne t'i

22 kuptojmë ato. Dhe t'i japim një lloj kuptimi kohës. Është, ka

23 qenë një ditë e parë kur janë bërë varrimet. Dhe pastaj një

24 ditë tjetër, janë bërë varrime të tjera. Ka një rend të

25 caktuar pra se si janë bërë gjëra dhe kështu të gjitha këto

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 kanë kuptim.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por  
3 nuk e kuptoj pse duhet të shkojmë te spitali dhe te morgu. Unë  
4 nuk arrij ta kuptoj pse ose ma shpjegoni më qartë, por  
5 përndryshe nuk do të vazhdojmë ta shikojmë këtë filmim. Sepse  
6 është edhe çështje parimi. Dua të më tregohet, të demonstrohet  
7 që këto filmime janë relevante.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Numri i arkivoleve nuk është i  
9 njëjtë për të gjitha ato varrimet. Dhe kjo do të na ndihmojë  
10 të kuptojmë sipas mendimit tim, në mënyrë më të qartë, se kur  
11 janë ndodhur, kur kanë ndodhur këto.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur  
13 kanë ndodhur çfarë?

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Të këtyre funeraleve, të këtyre  
15 varrimeve. Sepse në ato varrime ka disa elemente të cilat mund  
16 të krahasohen me disa informacione që kanë dhënë dëshmitarët e  
17 Prokurorisë. Ne nuk do të shprehim mendimin tonë, sigurisht,  
18 kjo do të vijë më vonë, por duam të japim realitetin dhe të  
19 tregojmë se për çfarë është ky filmim, dhe të tregojmë që këto  
20 filmime nuk përputhen me ato që kanë thënë disa dëshmitarë të  
21 Prokurorisë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së  
23 pari, do t'i kërkoj dëshmitarit që të vijë përsëri këtu.

24 Dhe e shikoj kohën. Nuk ka kohë që ta shohim filmimin.  
25 Nuk do të vazhdojmë më tej, do të bëjmë pushimin e drekës dhe

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 pastaj do ta vazhdojmë më tej. Por, përpara se ta bëjmë këtë  
2 do të pyes Prokurorin dhe Mbrojtësin e Viktimave nëse kanë  
3 mendime për të.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] S'kam ndonjë parashtrim për  
5 bërë. Këto filmime lidhen me periudhën e aktakuzës, por unë  
6 pajtohem me mendimin tuaj se nuk është shumë e qartë se çfarë  
7 kërkon që të nxjerrim nga këto video.

8 Ndoshta mund të fillohet që t'i shikojmë ato dhe pastaj  
9 ju, të nderuar Gjykatës, mund të vendosni nëse janë relevante  
10 apo jo.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Faleminderit. Do ta shikojmë më vonë. Akoma nuk duhet të vijë  
13 dëshmitari.

14 Mbrojtës i Viktimave, keni diçka për të thënë?

15 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
17 Aouini?

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Sa për të dhënë diçka para pushimit  
19 për relevancën. Ne besojmë që kjo është relevante sepse kemi  
20 disa deklarata, do t'ju jap dhe referencat të nderuar  
21 Gjykatës. Domethënë, deklarata të dëshmitarëve që kanë thënë,  
22 që z. Shala erdhi në të njëjtën kohë me këto trupat apo  
23 kufomat apo të plagosurit.

24 Pra, për të sqaruar që z. Pjetër Shala nuk ishte aty në  
25 kohën, nuk erdhi në të njëjtën kohë me këto. Mund t'ju jap

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 edhe referencat që është 06024-TR-ET [Sipas përkthimit] e  
2 rishikuar në faqen 144, 145. Dhe mund t'jua jap edhe  
3 pseudonimin e dëshmitarit.

4 Po kështu kemi edhe një dëshmitar i cili tashmë është i  
5 ndjerë, që përmendi [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR] Pra e di që jemi në

7 seancë publike dhe prandaj s'po e përmend.

8 Pra, në përgjithësi këtu kemi një video që është inçizuar  
9 atë ditë dhe është shumë e rëndësishme për të parë se kush ka  
10 qenë aty dhe kush po bënte aktivitete në atë kohë, dhe për të  
11 parë nëse kishte brigada, formacione. Ashtu si tha z.

12 Gillisen, për të parë realitetin se çfarë ka ndodhur dhe cilët  
13 njerëz ishin të përfshirë.

14 Për të parë se çfarë kuptimi ka kjo, duhet të shikojmë  
15 numrin e arkivoleve sepse kemi të bëjmë me tre ditë,  
16 domethënë, të ndryshme, sepse varrimet janë kryer gjatë pesë-  
17 gjashtë ditëve. Sepse kemi dy ditët e para, pastaj është bërë  
18 varrimi i tretë më vonë. Për shembull, një ushtar vdiq në  
19 Tiranë dhe ai është sjellë për varrim më vonë. Pra kjo ka të  
20 bëjë me një element tjetër që [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 Referenca në mendjen e dëshmitarit është më shumë për ato  
23 sa kufoma ka aty. Pra, ai duhet të shikojë pak në sfond në  
24 lidhje me këto pjesë, që ai të kuptojë se cila datë ka qenë.  
25 Një nga ato videot ka të bëjë vetëm me një fjalim që përmend

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 datën. Pra, për t'i kuptuar të gjithë këtë, duhet, na lejohet  
2 për të qenë pak më efiçentë, na lejohet pak kohë në mënyrë që  
3 të jemi më efiçentë. Z. Gillisen do që të jetë efiçent me  
4 kohën, dhe prandaj i kemi bërë të shkurtra këto pjesë, por na  
5 duhet t'i tregojmë këto në mënyrë që dëshmitari të kuptojë për  
6 çfarë po flasim. Dhe të mos sillemi rrotull për të parë se  
7 çfarë është interesante apo jo, çfarë është relevante apo jo.  
8 Është shumë me rëndësi për të parë a është relevante për të  
9 parë që a ka pasur formacione, çfarë formacionesh ka pasur,  
10 kush ka qenë aty, ngjarjet. Dhe kjo lidhet me disa nga  
11 deklaratat e dëshmitarëve të Prokurorisë që kanë dhënë për  
12 datat 31 maj, 1 qershor edhe 2 qershor.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
14 bëhet fjalë vetëm për kohën, sepse po të ishte vetëm për kohën  
15 atëherë do t'i shihnim këto pamje dhe do të shkonte, do të  
16 ecte puna më mirë. Puna është Paneli duhet të kuptojë, Trupi  
17 Gjykues duhet të kuptojë se pse po na jepen këto dhe çfarë  
18 peshe kanë? Në mënyrë që të shohim, të kuptojmë, të dëgjojmë  
19 se çfarë do të thotë dëshmitari. Sepse unë për momentin vetëm  
20 po hamendësoj se pse duhet të jepen këto pamje. Pra,  
21 domethënë, ka të bëjë me sfondin në lidhje me atë që po bëjmë  
22 ne këtu si Trup Gjykues.

23 Megjithatë, ta sjellim përsëri dëshmitarin përpara se të  
24 bëjmë pushim.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]



*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
2 Faleminderit që erdhët z. Dëshmitar, megjithëse ju kemi sjellë  
3 vetëm për t'ju informuar se kemi finalizuar diskutimin tonë,  
4 dhe do të vazhdojmë me seancën pas pushimit të drekës.  
5 Shpresoj t'ia kaloni mirë gjatë drekës. Edhe faleminderit për  
6 durimin me gjithë këto hyrje e dalje gjatë mëngjesit. Do të  
7 vazhdojmë në orën 14.30.

8 Znj. Asistente, mund ta shoqëroni jashtë dëshmitarin.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
11 bëjmë pushim tani dhe do të vijmë përsëri në orën 14.30.

12 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

13 --- Seanca rifillon në orën 14.30

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
15 se u kthyet! Po shoh një herë ekipet. Shoh që ZPS-ja ka të  
16 njëjtit përfaqësues.

17 Në të majtë po i njëjti ekipi. Edhe Mbrojtësi i Viktimave  
18 po pohon me kokë.

19 Në rregull. Vazhdojmë me seancën e pasdites.

20 Sa i takon videove, Mbrojtës, ne do bëjmë kështu: Do të  
21 vazhdojmë me videot që ju keni sikurse i keni parashtruar në  
22 dokumentin që i keni çuar Trupit Gjykues. Parimisht, do ju  
23 lejojmë t'ia shfaqni dëshmitarit. Mund të jenë nja dy segmente  
24 për të cilat do ju kërkoj të më jepni më shumë sqarim, por  
25 sidoqoftë vazhdojmë -- siç ishte planifikuar.

1 Ju lutem, sillni dëshmitarin.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Dëshmitar, mirë se erdhët.

5 DËSHMITARI: Mirë se ju gjej.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Shala, mirëdita. E merrni përkthimin?

8 I AKUZUARI: Mirëdita, po. Po e dëgjoj mirë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
10 mirë.

11 Avokat, fjala është për ju.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] I drejtohem Sekretares së  
15 Gjykatës. Ju lutem, vendosni në ekran materialin me numër ERN  
16 078 [sipas përkthimit]. Të vendosni konkretisht segmentin e  
17 minutës së 19-të, pra, -- vendosni, ju lutem, minutën e 6-të,  
18 sekonda e 19-të, minuta e 7-të, sekonda e 27-të. Materiali me  
19 numër ERN 075138-01.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
21 lutemi, vendoseni në ekran, Sekretare.

22 [Luhet videoincizimi]

23 Z. GILISSEN: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, a mund të na shpjegoni çfarë pamë në ekran ne  
25 tani?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
2 Avokat, a mund të fillojmë me sekuencën që propozuat -- me  
3 radhën që propozuat vetë? Fillimisht pyesni nëse e ka parë, ku  
4 e ka parë dhe kur.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, A jeni ju personi që i keni incizuar imazhet  
7 që sapo pamë?

8 PË. Po, unë e kam incizu.

9 PY. A mund të na thoni kur, në cilën, kur nga pikëpamja  
10 kohore, kur e keni incizuar këtë?

11 PË. Ky incizim është më 1 qershor. Faktikisht është morgu i  
12 spitalit të Kukësit kur i kemi tërheq kufomat e tre dëshmorëve  
13 të kombit.

14 PY. Po flisni për tri persona. A mund të na shpjegoni çfarë -  
15 - do të thotë ky numër --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
17 lutem, Sekretares, ndërkohë të heqë -- videon. Ju kërkohet  
18 ndjesë që ju ndërpreva Avokat. Duhet hequr video nga ekrani.  
19 Edhe një herë.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim]

21 PY. A mund të shpjegoni çfarë do të thotë për ju, çfarë --  
22 përfaqëson ky numri tre. Po flasim ky numri tre janë  
23 arkmortet, janë arkivolet? Çfarë është numri tre?

24 PË. Faktikisht janë tri arkivolet, tre dëshmorë të kombit  
25 tonë.

1 PY. Ky, kjo është e vetmja ceremoni mortore ku janë varrosur  
2 tre trupat?

3 PË. Po.

4 PY. Faleminderit. A jeni në gjendje të identifikoni brigadën  
5 apo njësitet? Pra, cilit njësit apo brigadë u përkisnin  
6 personat që pamë në këtë video?

7 PË. Këta kanë qenë faktikisht ushtarë të njësitetit të Ruzhdi  
8 Saramatit.

9 PY. A mund ta identifikoni njësitetin në fjalë, atë të Ruzhdi  
10 Saramatit? A mund të na jepni një shifër, një numër apo emër?

11 PË. Nuk di, nuk di as emër që ka pas faktikisht. S'po më  
12 kujtohet, s'po më kujtohet çfarë emri ka pas. Vetëm e di që e  
13 ka udhëheq, q'atë brigadë e ka udhëheq Ruzhdi Saramati e ka  
14 udhëheq.

15 PY. Faleminderit shumë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
17 kam unë një pyetje sqaruese. Ta kuptoj unë si e identifikon ai  
18 këtë njësit? Mbase do ia bëni edhe ju këtë pyetje. Ai e ka  
19 identifikuar. Po si mund ta identifikoni ju, Dëshmitar? Nga e  
20 dini më saktë?

21 DËSHMITARI: Po e kemi dit faktikisht se është fol aty; na  
22 kanë tregu si cilit këta ushtarë të cilit njësit kanë qenë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
24 rregull.

25 DËSHMITARI: Historikisht, faktikisht i kanë ra aty në

1 pritë kanë ra edhe janë vra pesë ushtarë, janë vra në të  
2 njëjtën vend.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I  
4 drejtohem Avokatit. Ishte nevoja ta bënim këtë sqarim për  
5 identifikim.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shohim videoklipin tjetër me të  
7 njëjtën ERN, por minuta e 8-të, sekonda e 47-të deri në  
8 minutën e 9-të, sekonda e 10-të. Unë mund t'ju shpjegoj edhe  
9 arsyen. Por është e nevojshme që ta shfaqim këtë ekscerpt,  
10 këtë fragment.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
12 vazhdoni me videon.

13 [Luhet videoincizimi]

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, po këtë, ju e keni incizuar me kamerën tuaj?

16 PË. Po, unë e kam incizuar.

17 PY. Shumë faleminderit. A jeni në gjendje të na shpjegoni  
18 çfarë pamë në këtë video tani?

19 PË. Faktikisht këtu pamë rrugëtimin e prej spitalit të  
20 Kukësit te varrezat. Është kufoma e Selver Mackajt. Në ballë  
21 të kufomës së tina është baba i tina, Bajram Mackaj, që pesë  
22 ditë përpara ia kanë -- kallë edhe çikën në Prizren forcat  
23 serbe të gjallë. Mbas pesë ditë iu ka vra edhe djali.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
25 lutem, përgjigjuni pyetjes. Mos na jepni detaje të tjera.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim]

2 PY. Kush janë personat që mbajnë lulet?

3 PË. Po faktikisht janë ushtarë të thjeshtë janë. Nuk i di si  
4 figura, si emra nuk i njoh.

5 PY. A ishte e zakonshme, ishte normale që të çoheshin lule  
6 për funeral, për ceremoni mortore?

7 PË Po, normal.

8 PY. Është e -- vetmja ditë që janë çuar lule apo njësoj janë  
9 për të gjitha ceremonitë mortore, çohen lule?

10 PË. Jo. Ditën e parë, faktikisht, nuk janë çu lule se nuk  
11 kemi qenë as të përgatitun ditën -- varrimin e dytë edhe  
12 varrimin e tretë po.

13 PY. Kemi buqetë me lule, tufë me lule apo kurorë -- kurorë me  
14 lule. A ishte situata ndryshe për ceremonitë e ndryshme  
15 mortore, domethënë, çoheshin buqeta, kurora?

16 PË. Ka pas edhe buqeta edhe kurora ka pas.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Avokat, po bëni pyetje sugjestionuese. Bëjini pak më të hapura  
19 pyetjet. Ju po i paraprini përgjigjes. Ju lutem, mos bëni më  
20 pyetje sugjestionuese. Ju e dini shumë mirë këtë gjë.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju kërkoj falje.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se  
23 nuk më pëlqen t'ju ndërpres.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Me lejen tuaj, e  
25 nderuara Gjykatëse, duam të shohim -- një segment tjetër me të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 87

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 njëjtën ERN 075857-TR-ET [sipas përkthimit]; minuta e 9-të,  
2 sekonda e 12-të deri tek minuta e 9-të, sekonda e 17-të.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
4 lutem, Sekretare, vendoseni në ekran.

5 [Luhet videoincizimi]

6 Z. GILISSEN: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, ku është incizuar kjo pjesë, e dini?

8 PË. Kjo është rruga, faktikisht, prej Kukësit për Krume që  
9 shkon te varrezat. Ajo rruga kryesore është. Dikun është tek  
10 uzina aty dikun është.

11 PY. Jeni ju personi që e keni bërë këtë incizim?

12 PË. Po.

13 PY. A e dini cilit njësit janë këta ushtarët që janë këtu në  
14 rresht?

15 PË. Jo, nuk e di, nuk e di.

16 PY. A mos është vazhdimi i videos që pamë pak më përpara kjo?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
18 ta pyesni edhe kur, çfarë ditë është incizuar kjo?

19 DËSHMITARI: Kjo është incizuar me 1 qershor 1999.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim]

21 PY. Shumë faleminderit, shumë e qartë.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të shohim një segment  
23 tjetër me të njëjtën ERN dhe minutazhi, minuta 9, sekondat 35  
24 deri në minutën e 9-të, sekonda e 50-të.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 lutem, Sekretare, vendoseni në ekran.

2 [Luhet videoincizimi]

3 Z. GILISSEN: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, ju e keni incizuar këtë?

5 PË. Po.

6 PY. Ku është, ku është ky vend; në cilin vend është bërë ky  
7 incizim?

8 PË. Saktësisht është te varrezat e Kukësit. Janë familja -- e  
9 Selver Mackajt.

10 PY. Kjo do ishte pyetja ime e radhës, por ju e dhatë  
11 përgjigjen. Faleminderit. Jeni shumë i qartë.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar  
13 Gjykatës, do doja të shihnim segmentin e fundit të kësaj  
14 video. Minuta 10, sekonda 25 deri në minutën e 12-të, sekonda  
15 e 30-të.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
17 lutem, Sekretare, vendosni në ekran.

18 [Luhet videoincizimi]

19 Z. GILISSEN: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, a jeni ju personi që i ka incizuar këtë  
21 ngjarje, këtë imazh?

22 PË. Po.

23 PY. Ku është incizuar kjo pjesë, në cilin vend?

24 PË. Kjo pjesë është incizum në kuzhinën brenda në uzinë. Mbas  
25 varrimit është familja e Selver Mackajt, është babai i



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 89

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 Selverit tash i ndjerë, nëna e Selverit, dy djemtë e Selverit,  
2 vajza edhe gruaja.

3 PY. A mund të na shpjegoni kur data kur është incizuar?

4 PË. Me 1 qershor 1999.

5 PY. Shumë faleminderit.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Duam që të na ndihmoni që të  
7 identifikojmë disa nga personat. Fillimisht tek minua e 10-të,  
8 sekonda e 31.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
10 lutem, Sekretare, vazhdoni.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, kush është ky personi që ka uniformë dhe ka  
13 mjekër, e njihni?

14 PË. Bedri Azemi.

15 PY. Faleminderit. Po personin përbri -- tij që është po ashtu  
16 me uniformë, e njihni?

17 PË. Si figurë, po, por emri s'më kujtohet.

18 PY. Në rregull.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shohim imazhin në minutën e 12-  
20 të, sekonda e 26-të.

21 PY. Z. Dëshmitar, a njihni ndonjë nga personat që shfaqen në  
22 këtë imazh?

23 PË. Po është --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Prisni ju lutem.

1 Avokat, doni emrat e të dy personave apo personit që  
2 është në të majtë?

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do doja të dija emrin e personit  
4 që është me uniformë -- nëse është e mundur le të identifikojë  
5 edhe vajzën.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse  
7 thatë personat. Po. Dëshmitar, ju lutem, identifikoni vetëm  
8 personin në uniformë.

9 DËSHMITARI: Është Shefki Avdullahu.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim]

11 PY. Po vajza? A mund të na thoni -- mund të na jepni ndonjë  
12 informacion për vajzën?

13 PË. Vajza e dëshmorit Selver Mackajt. Më duket Silvana e ka  
14 emrin, nuk jam i sigurt.

15 PY. Shumë faleminderit. Mjafton. Dëshmitar, a konfirmoni që  
16 videot që pamë deri tani janë incizuar ditën e funeralit --  
17 pra, ditën e ceremonisë së parë mortore, kjo ka qenë?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pse  
19 nuk e bëni një pyetje të hapur, Avokat? Thjesht pyeteni, jo  
20 është hera e tretë që po ju kërkoj të bëni pyetje të hapur.  
21 Pesha që do t'i japim ne në mënyrë objektive dallon nga --  
22 është në varësi të mënyrës se si bëni ju pyetjet.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Keni shumë të drejtë. Po shihja  
24 dhe orën --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ora

1 është halli -- puna ime. Për atë punë paguhem unë. Vazhdoni.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, të gjitha këto pamje që pamë deri tani, a kanë  
4 qenë pamje të së njëjtës ditë; incizime të së njëjtës ditë dhe  
5 cila ditë ka qenë kjo?

6 PË. Po të njëjtës ditë kanë qenë, faktikisht, më 1 qershor  
7 1999.

8 PY. Faleminderit.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për -- tani mund të shkojmë në  
10 videon numër 2, ERN DPS00879.

11 PY. Dëshmitar, do ju tregojmë një pjesë të videos së dytë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Avokat, për këto katër videot do të kisha nevojë për një  
14 sqarim. Jo për të gjitha, por të paktën për këtë video  
15 konkrete do doja që të diskutonim pak.

16 Dëshmitar, do të duhet të dilni sërish një çast nga salla  
17 e gjyqit për dy minuta.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
20 mund të na jepni sqarime për katër videot që shoh që dëshironi  
21 t'ia tregoni dëshmitarit.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Patjetër.

23 Për segmentin e parë është thjesht çështje identifikimi  
24 të personave. Segmenti i dytë është shumë i rëndësishëm se  
25 duam do të dëgjojmë një fjalim aty. Të paktën pjesën, vetëm

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 fillimin e fjalimit, jo të gjithë. Sepse aty do të dëgjojmë  
2 dhe marrim informacione për njoftimin, për identifikimin e  
3 personave që kanë qenë, pra, në funeralin e personit edhe  
4 datën. Këtu kemi evidentim të saktë të datës. Prandaj duam që  
5 të shfaqet kjo video.

6 Kemi edhe një segment të tretë që është në vazhdimësi mes  
7 segmentit që pamë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 [Mikrofoni çaktivizuar]

10 Por çfarë relevance ka. Unë nuk do ta ndaloj, por po  
11 përpiqem të kuptoj relevancën. I pamë, i kemi parë të gjitha,  
12 madje disa herë i kemi parë.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Thjesht çështje identifikimi, siç  
14 e tha edhe z. Aouini. Ne duam të tregojmë kush ka qenë aty dhe  
15 kush nuk ka qenë aty.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a  
17 është e nevojshme, është realisht e domosdoshme të dëgjojmë  
18 fjalimin e dytë?

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Vetëm, vetëm pak, vetëm fillimin,  
20 vetëm fillimi i fjalimit është i rëndësishëm. Segmenti i parë  
21 është vetëm për të treguar lidhjen, vazhdimin me videot e  
22 tjera. Në qoftë se ju gjykoni që nuk është e nevojshme, e  
23 kuptoj. Ishte më shumë për t'i dhënë kontekstin.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Datën  
25 e keni që thatë që është e rëndësishme. Doni të identifikoni

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 personat në videon e dytë, po këtë vazhdimësinë s'po e kuptoj  
2 ku është relevanca.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është faktikisht ekstrakti --

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Ekstrakti i dytë, e keni fjalën.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Minuta e 2-të, sekonda e 43, deri  
7 në minutën e 2-të. Do donim që dhe përkthyesit të na ndihmojnë  
8 të kuptojmë tamam fjalët që po përdoren në këtë fjalim.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
10 ka transkript; nuk ka transkript.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] E kemi transkriptin në faqen ERN  
12 DPS00879-TR-ET, faqja 1 anglishtja; shqipja është me ERN  
13 DPS00879-TR-ET [sipas përkthimit].

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që ta  
15 kuptoj unë pse duhet që ta lexojnë përkthyesit në qoftë se  
16 kemi transkriptin?

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për të pasur një konfirmim prej  
18 tyre. Është saktësisht kjo data -- elementi i datës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por  
20 në qoftë se kemi transkriptin mjafton. Nëse ju e kontestoni  
21 saktësinë e transkriptit të përkthimit më saktë, ne kemi, kemi  
22 procedurë apostafat për këtë.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk e kishim këtë për qëllim.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Atëherë e lemë, e lemë mbajmë transkriptin për momentin. Në

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 rregull. Heqim -- videon e tretë dhe ekstrakti i videos së  
2 fundit.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kemi një video që nuk e kemi për  
4 synim ta tregojmë, në fakt, nuk synojmë ta tregojmë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
6 doni të tregoni vetëm dy video tani?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, atë që fillon në minutën --  
8 minuta e 2-të, sekonda 43 dhe tjetra që fillon në minutën -- e  
9 7-të, sekonda e 33.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
11 rregull atëherë. Pra, e para -- pra, të parën nuk do ta  
12 tregoni?

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk do ta tregojmë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
15 Atëherë do të tregoni video e tretë dhe të katërt. Shumë mirë.  
16 Tani po shfrytëzoj dhe mundësinë të kalojmë një çast në  
17 sekondë [sipas përkthimit] private që të diskutojmë diçka dhe  
18 pastaj dalim -- kalojmë sërish në seancë publike dhe vazhdojmë  
19 me dëshmitarin.

20 Znj. Sekretare, ju lutem, a mund të hymë në seancë  
21 private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

6 mund të vijë dëshmitari?

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

9 se erdhët përsëri, Dëshmitar! Menjëherë do t'ia jap përsëri  
10 fjalën Mbrojtësit.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

12 Pra, dua shikojmë fragmentin në ekran nga minuta 2:43  
13 minuta deri në 5 minuta e 7 sekonda.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga  
15 minuta e 4-t apo jo?

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po.

17 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Seancës  
18 këshillohen]

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dëshiroj të luhet edhe zëri në  
20 këtë video.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Mbrojtës, për sa i përket transkriptit do të kemi videon, do  
23 kemi transkriptin në gjuhën shqipe. Nuk e di nëse ju kam  
24 keqkuptuar, por pastaj transkripti në shqipe do të përkthyer  
25 me gojë. Pra, jo zëri që do të dëgjohet në video, por



1 transkripti që është me shkrim ai do të interpretohet, do të  
2 përkthehet për ne.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, duhet të bëhet lidhja midis  
4 zërit dhe transkriptit.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po jo  
6 zëri nga video. Nuk e duam. Do të përkthehet nga letra, nga  
7 transkripti.

8 Ju lutem, Sekretare, të luhet video. Të nxirret në ekran  
9 dokumenti. Ju lutem vazhdoni, Sekretare.

10 [Luhet videoincizimi]

11 PËRKTHYESI:

12 "[e pakuptueshme] Dje me 31 maj 1999 në vijën e parë të  
13 fronit në tokën e Kosovës ranë heroikisht dëshmorët e lirisë:  
14 Bajram -- Selver Bajram Mackaj nga Ljubiceva e Prizrenit, Ilir  
15 Ukmataj dhe Shpend Berisha nga Drenica, komandant batalioni.

16 Ushtarë të nderuar, dëshmorë të kombit, sot me dhembje të  
17 madhe po ndahemi prej jush, por ju shkruat me gjakun tuaj një  
18 fletë të re të historisë sonë të madhe kombëtare. Gjaku juaj  
19 vaditi bjeshkët e Hasit, ra në Drinin e Bardhë dhe u bashkua  
20 me liqeni ne Fierzës. Ky ishte amaneti juaj dhe amaneti i  
21 prindërve tuaj që sot janë pranë jush, pranë varreve tuaja në  
22 Kukësin e tokës shqiptare. Pranë jush janë edhe  
23 bashkëluftëtarët tuaj, komandantët që janë tubuar sot për  
24 t'ju dhënë nderimin që ju e merituat. Pranë jush -- ".

25 Z. GILISSEN: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, jeni -- e keni marrë ju këtë incizim; e keni  
2 bërë ju këtë incizim?

3 PË. Po këtë incizim e kam marrë unë, por faktikisht këtu po  
4 figuron një emër krejt tjetër. Po figuron Esat Shala. Se  
5 faktikisht, në njëfarë mënyre nuk është autor Esat Shala, por  
6 autori i filmit jam unë.

7 PY. E njihni këtë person që po mban fjalimin këtu?

8 PË. Si figurë po, por emrin nuk ia di.

9 PY. Po njësitin apo batalionin a ku përkiste ai, a e dini?

10 PË. Jo, jo nuk e di.

11 PY. Faleminderit. Besoj që mjafton për këtë incizim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
13 të hiqet, znj. Sekretare.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Tani dua të paraqitet pjesa e  
15 fundit e këtij -- e kësaj videoje. Pra, ka të njëjtin numër  
16 ERN, 075138 nga -- më falni është ERN, DPS00879 dhe është nga  
17 minuta 7:33 deri në 8:49.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Vazhdoni, nxirreni në ekran, Sekretare.

20 [Luhet videoincizimi]

21 PËRKTHYESI:

22 "[e pakuptueshme] Një minutë të mbarojmë punë, vazhdo. [e  
23 pakuptueshme] Ndhimoheni, ndhimoheni [e pakuptueshme] Ulu pak.  
24 Bjere dhe tjetrin, kape dhe tjetrin [e pakuptueshme]. Po  
25 flamurin. [e pakuptueshme] lërja atij më mirë. Kape mes

1 këmbëve, Ismet. Vërja kapakun këtij një herë. Venja kapakun se  
2 e mbushim me dhenë -- po e rregullojmë [e pakuptueshme]”.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

4 PY. Dëshmitar, a e keni bërë juve këtë incizim?

5 PË. Po. Unë e kam incizu, por faktikisht është vjedh. Esat  
6 Shala e ka qit në emër të vet e ka qit. A këto janë incizime  
7 të mia që unë i kam bë.

8 Se Esat Shala faktikisht gjatë luftës kanë qenë dikun 10-  
9 vjeçar, 11-vjeçar, nuk ka qenë më shumë. Një farë mënyrë është  
10 tuj e falsifiku edhe historinë është tuj e falsifikue. Këto  
11 janë incizime të mia direkte që unë vetë me dorën teme i kam  
12 bë.

13 PY. A mund të na thoni se sa arkivole shihen në këtë incizim,  
14 në këtë video?

15 PË. Unë në këtë video janë tri arkivole janë faktikisht. Tre  
16 dëshmorë i kemi varros atë ditë. Ditën e parë më 1 qershor  
17 1999. Tre dëshmorë kanë qenë.

18 PY. Faleminderit.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kaq kisha pyetje për këtë video.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
21 Faleminderit, Mbrojtës.

22 Tani do të kalojmë n videon e tretë. Nuk ka nevojë të  
23 dalë dëshmitari. Kam vetëm një pyetje në lidhje me videon e  
24 parë që ishte shumë e shkurtër që donit ta tregonit. Ne kemi  
25 pasur filmim edhe të një vendi të ngjashëm me të. Nuk e di

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 100

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 nëse ishte e nevojshme kjo, nëse e keni të vështirë të thoni  
2 po apo jo. Nëse insistoni mund ta shikojmë.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo. Thjesht ishte për të treguar  
4 vazhdimësinë, por nuk është e domosdoshme.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
6 rregull. Atëherë s'ka nevojë të dalë dëshmitari dhe mund të  
7 vazhdoni me videon tjetër.

8 Keni fjalën.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

10 Në këtë video të tretë dua të filloj me një Provën  
11 Materiale ERN 075138-02 [sipas përkthimit]. Fillon nga 12:40  
12 deri tek 13:55.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Sekretare, ju lutem, hiqini videot e mëparshme dhe vazhdoni,  
15 vendosni këtë video.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më falni. Dua ta përsëris edhe  
17 një herë numrin ERN 075138-02.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
19 ta luani videon, Sekretare.

20 [Luhet videoincizimi]

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Atëherë, z. Dëshmitar, i keni marrë ju këto pamje?

23 PË. Po.

24 PY. Ku është filmuar kjo skenë?

25 PË. Kjo skenë faktikisht komplet është i filmue në oborrin e

1 uzinës.

2 PY. A e dini se cila njësi, nga cila njësi apo nga brigada --  
3 cila brigadë ishin këta ushtarë që tregohen aty?

4 PË. Jo, nuk e di. Faktikisht, do ushtarë janë të logjistikës  
5 që kanë qenë aty në kazermë edhe të tjerët nuk e di, nuk e di  
6 çfarë brigade kanë qenë, nuk e di.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund t'i kthehemi edhe një herë  
9 fillimit të videos për të treguar një pamje. Është në minutën  
10 12, sekonda e 41-të, për të marrë një pamje fikse.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
12 ta nxirrni znj. Sekretare.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe një herë do ta përsëris  
14 referencën. Është 12 minuta e 41 sekonda.

15 PY. Z. Dëshmitar, a mund të na thoni se cilën pjesë të uzinës  
16 po shikojmë në këtë imazh, në këtë pamje?

17 PË. Kjo është, faktikisht, te dyert te dalja e uzinës. Është  
18 dalja e uzinës, dyert e mëdhaja, faktikisht, është dalja e  
19 uzinës.

20 PY. Po. Pamë disa njerëz aty. Janë disa ushtarë femra me  
21 bereta të kaltra në anën e djathtë. A e dini se çfarë do të  
22 thotë kjo bereta e kaltër?

23 PË. Jo, s'di çfarë domethënie ka. Jo, nuk e di.

24 PY. Sipas jush nuk ka asnjë kuptim?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e

1 ka tha këtë. Ai tha nuk e di se çfarë domethënie ka. Është  
2 ndryshe, Mbrojtës.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë atë desha të kërkoj që mos të  
4 humbim asnjë lloj informacioni.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ju  
6 nuk po kërkonit informacion, po jepnit informacion, Mbrojtës.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të shkojmë te një foto  
8 fikse në minutën në 13:07 sekonda.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
10 kthehem përsëri që ta theksoj dhe një herë. Dëshmitari tha,  
11 "Unë nuk e di domethënien", dhe ju thatë "Nuk ka kuptim". Pra,  
12 po kjo është një diçka tjetër, sepse ju mund të thoni që nuk e  
13 dini kuptimin, por ajo mund të ketë ndonjë kuptim.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jam shumë dakord, por në gjuhën  
15 time kjo do të thotë e njëjta gjë. Domethënë unë e di ndoshta  
16 në anglisht nuk është e njëjta gjë, por në frëngjishte është e  
17 njëjta gjë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtu  
19 kemi -- flasim anglisht dhe nuk përdoret frëngjishtja.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po unë desha që të di  
21 informacionin e plotë, ekzaktësisht.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] T'i  
23 kthehem dhe një herë pamjes që sapo pamë, sepse do të  
24 diskutojmë edhe një herë për këto beretat e kaltra. Sepse dua  
25 që procesverbalin ta kemi pamjen fikse ku duken beretat blu

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F793  
Pyetje nga z. Gilissen Faqe 103  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 ose të kaltra.

2 Sekretare, ju lutem, a mund të na e tregoni edhe një herë  
3 ta shfaqni edhe një herë videon.

4 Dëshmitar, ju lutem, shikoni me kujdes pamjen e personave  
5 që mbajnë në kokë beretat e kaltra.

6 [Luhet videoincizimi]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
8 mund të shënojmë. Është 12 minuta e 59 sekonda.

9 Z. Dëshmitar, së pari është minuta e 12:59 sekonda dhe ju  
10 lutem, Sekretares të hymë pak në seancë private.

11 [~~Seancë private~~] [Seancë e hapur] Riklasifikuar në  
bazë të F793

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 Dëshmitar, a njohe ndokënd nga ato me bereta të kaltra?

16 DËSHMITARI: A bën veç një sqarim dy minuta? A ka mundësi?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
18 ju kuptoj, sqarim? Ju duhen dy minuta për me bë një sqarim?

19 DËSHMITARI: Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Doni  
21 ju të dilni?

22 DËSHMITARI: Të sqaroj për këto bereta, për q'atë arsye.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
24 rregull. Por në fillim përgjigju pyetjes time dhe pastaj do  
25 t'ju jap mundësinë të sqaroni, sepse mund ta bëjmë sqarimin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F793  
Pyetje nga z. Gilissen Faqe 104  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 edhe në seancë publike. Domethënë, pyetja ime: A njihni

2 ndokënd këtu?

3 DËSHMITARI: Nuk njoh kërrkënd, jo.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Sekretare, ju lutem, të hymë përsëri në seancë publike.

7 ~~[Seancë e hapur]~~

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

9 jemi përsëri në seancë publike.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë

11 deshët të sqaronit në lidhje me beretat e kaltra?

12 DËSHMITARI: Desha veç të sqaroj diçka që faktikisht

13 Ushtria Çlirimtarë e Kosovës ka qenë ushtri vullnetare. Ne as

14 nuk kemi pas fabrika për me prodhu uniforma të njëjta, as me

15 prodhu kapela të njëjta, por faktikisht qysh na kanë ardhë

16 uniformat edhe kapelat edhe të gjitha pajisjet prej perëndimit

17 ashtu edhe i kemi përdorur.

18 Ja në të njëjtën fotografi anën e djathtë personi i parë

19 e ka kapelën e kuqe. Ka me kapela të gjelbërta. Na s'kemi pas

20 fabrikat tona për me prodhu faktikisht uniforma me qenë të

21 gjithë të njëjtë. Kemi qenë ushtri vullnetare. Se në atë kohë

22 s'kemi qenë shtet, qysh jemi sot. Q'ato desha me sqarue.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit, Dëshmitar. E shënuam.

25 Mbrojtës, keni fjalën përsëri.



1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë të shikojmë  
2 foton nga minuta 30:41 sekonda.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jeni  
4 i sigurt?

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] 13:40; 13:14; 13 minuta e 14  
6 sekonda.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 parashtrimin që keni bërë shikoj 13:56 sekonda.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, por kjo është një ndërtesë që  
10 është identifikuar më parë dhe që të mos humbim shumë kohë nuk  
11 ka nevojë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Atëherë znj. Sekretare është minuta e 13-të, e 14 sekonda.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, kjo është.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Atëherë kjo qenka gjysmë minuti më shumë. Mund të vazhdoni.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim]  
18 PY. A jeni në gjendje të identifikoni dy ndërtesat që  
19 shikojmë? Sa për të qenë të sigurt që nuk është bërë ndonjë  
20 gabim.

21 PË. Po në anën e majtë faktikisht është komanda, drejt  
22 faktikisht ku është dera çelun është kuzhina. Mbrapa ushtarëve  
23 dera çelë që është kuzhina.

24 PY. Shumë e qartë, faleminderit. Dhe këta burrat që janë para  
25 ndërtesës a e dini se në cilën brigadë ishin?

1 PË. Faktikisht pjesa më e madhe ka qenë policia ushtarake se  
2 ka qenë edhe garda e nderit se edhe atë ditë kemi pas edhe një  
3 varrim. Faktikisht varroset dëshmori Abdurrahman Gëderllaj  
4 edhe kjo ka qenë përgatitje sipër për atë varrim.

5 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Tani do t'ju tregojmë edhe  
6 pjesën e fundit nga kjo video.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Sekretare, ju lutem, a mund të  
8 shfaqim në ekran të njëjtën video ERN 075138-02 dhe pjesën e  
9 fundit që nga minuta 13, 56 sekonda deri në 16 minuta e 1  
10 sekondë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
12 lutem, znj. Sekretare, mund ta shfaqni.

13 [Luhet videoincizimi]

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, a jeni ju personi që keni incizuar këto imazhe  
16 që sapo pamë?

17 PË. Po, unë i kam incizu.

18 PY. A e dini datën kur e keni bërë këtë incizim?

19 PË. Data është më 2 qershor 1999.

20 PY. Nga jeni kaq, si mund të jenë kaq i sigurt për datën?

21 PË. Po jam i sigurt se ditën e parë faktikisht me 1 qershor  
22 '99 i kemi varros tre dëshmorë, faktikisht. Me 2, ditën e 2-të  
23 me 2 qershor 1999 është varros Abdurrahman Gërdellaj edhe  
24 masanej vjen edhe dëshmori i katërt. Faktikisht me 4 qershor.

25 PY. A e dini dhe nga e dini, a e dini kujt i ishte kjo

1 ceremoni mortore dhe nga e dini?

2 PË. Është varrimi i dëshmorit Abdurrahman Gërdellaj.

3 PY. Po për çfarë arsye, nga e dini ju këtë?

4 PË. Po faktikisht ne e kemi dit gjithë ushtarët e kemi dit se  
5 kush është vra, tek është vra; na kanë tregu edhe komandantët  
6 tonë varrimi i kujna është. Për q'atë arsye edhe i kemi, i  
7 dimë këto informata. Pa marrë parasysh që kanë kalu 24 vite,  
8 por nuk harrohen. Janë do gjona që nuk harrohen; dëshmorët  
9 s'harrohen.

10 PY. A jeni në gjendje të na thoni disa detale lidhur me ato  
11 që kemi parë në këto fotografi që të sig -- pra, a mund të na  
12 jepni detaje që ne jemi të sigurt që është një funeral tjetër  
13 dhe është një ditë tjetër i ndryshëm nga ai që pamë pak më  
14 përpara? Çfarë -- hollësie mund ta bëjë dallimin?

15 PË. Po ditën e parë funeralin niset faktikisht prej spitalit  
16 të Kukësit. Aty janë -- tri arkivole.

17 Kjo është dita e dytë është faktikisht është vetëm një  
18 arkivol, vetëm një dëshmor është edhe niset nga uzina e jo nga  
19 spitali i Kukësit.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të shohim imazhin në  
22 sekondën e 14-të -- më falni -- minuta e 14-të, sekonda 39.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Sekretare, ju lutem, shfaqeni imazhin.

25 [Luhet videoincizimi]

1 Z. GILISSEN: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, a mund të dalloni vendin këtu?

3 PË. Kjo është dalja -- nga uzina.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shkojmë në imazhin e sekondës --

6 e minutës së 15-të, sekonda e 18-të. Faleminderit.

7 PY. Dëshmitar, a e njihni personat, a e shihni, a e njihni

8 personin në mes të fotografisë që po ecën?

9 PË. Jo, nuk e njoh.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Avokat, për procesverbal nuk është e qartë për kë person e

12 keni fjalën? Kështu që herën tjetër bëjeni më të saktë.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim]

14 PY. A jeni në gjendje pra, të identifikoni ndonjë person në

15 këtë fotografi, Dëshmitar?

16 PË. Nuk jam i sigurt në asnjë, faktikisht. Nuk jam i sigurt

17 se është edhe fotografia nuk është e mirë. Nuk po e shoh mirë.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] A është e mundur të vazhdojmë 1

19 ose 2 sekonda që të mos humbasim asgjë?

20 [Mikrofoni çaktivizuar]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

22 mirë kthehemi pas 5 sekonda dhe e lemë që të transmetohet 5

23 sekonda që të shmangim këtë prishjen e imazheve, që ta kemi më

24 cilësor imazhin, ta kemi më të qartë.

25 [Luhet videoincizimi]

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj se kaq mjafton.

2 PY. Dëshmitar, a jeni në gjendje të identifikoni ndonjë nga  
3 personat që pamë në imazhin e fundit?

4 PË. Ai që kaloi anash faktikisht, që qe me kapelë në dorë ai  
5 është Fadil Hoxha, përndryshe. Edhe që kjo e parafundit, në  
6 fund që tash, ka ik fotografia, është një vajzë një Nexhevane  
7 Ibrahimaj.

8 Se përndryshe të tjerët jo.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të shohim edhe një herë  
10 personin që u identifikua si Fadil Hoxha që të jemi të sigurt.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
12 rregull. Sekretare, kthejeni videon mbrapa. Aty ku e filluam  
13 herën e fundit; aty ku dëshmitarja [sipas përkthimit] arriti  
14 të identifikonte një nga personat në video. Faleminderit.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ndalojmë këtu.

17 PY. Dëshmitar, a mund ta shënoni me laps, me 1 personin që ju  
18 e identifikuat si Fadil Hoxha? Mund të vendosni numrin 1.

19 PË. [Shënon]

20 PY. Shumë e qartë. Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Sekretare, a mund ta ruajmë këtë imazh? Dhe ju lutem, jepini,  
23 vendosini numrin e Zyrës Administrative.

24 Dëshmitar, a ju kujtohet, ju e thatë një herë që ta  
25 sqaroni për mua, ju lutem. Çfarë, në cilën ditë i keni

1 incizuar këtë?

2 DËSHMITARI: Kjo është me 2 qershor; 2 qershor 1999.

3 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Seancës

4 këshillohen]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi që bëri

6 dëshmitari 03887 në imazhin me ERN 075138-02, sekonda --

7 minuta e 15, sekonda e 18 merr numrin e Zyrës Administrative

8 REG00990.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit.

11 Avokat, fjala është për ju.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, shohim lule në këtë pamje. Në këtë rast nuk

14 janë tufa, buqeta me lule. A mund të na jepni ndonjë shpjegim

15 lidhur me këtë? A ka ndonjë kuptim tjetër?

16 PË. Jo, kuptim tjetër nuk ka faktikisht, por ditën e parë kur

17 i kemi varros tre dëshmorët nuk kemi vu kurora lulesh. E ditën

18 e dytë, faktikisht, me 2 qershor kur kemi shku me varros edhe

19 Abdurrahman Gërdella atëherë -- ju kemi çu të gjithë

20 dëshmorëve nga një kurorë lulesh. Kjo është, s'ka tjetër.

21 PY. Faleminderit. Shumë e qartë.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të shohim imazhin në

23 minutën e 15, sekonda e 50.

24 Faleminderit.

25 PY. Dëshmitar, a e dini, cilit njësit i përkasin ushtarët që

1 janë këtu?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cilët  
3 ushtarë?

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Këta që shohim në imazh. Shohim  
5 tre. Dy kanë bereta të kaltra. Po e pyes, a e di cilit njësit  
6 i përkisnin.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
8 keni fjalën këta tre persona?

9 Po duhet ta specifikoni.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po keni të drejtë. Më konkret  
11 duhet të kisha qenë.

12 DËSHMITARI: Jo, nuk e njoh. As nuk e di cilës brigadë i  
13 kanë përkit.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim]

15 PY. Në rregull. I ke parë -- këta persona në uzinën e metalit  
16 në Kukës para apo pas funeralit më?

17 PË. Jo, asnjëherë.

18 PY. Faleminderit. Shumë i qartë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
20 lejo të shtoj diçka. Imazhi nuk është i qartë.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është në fakt, ashtu është. Po  
22 mund ta lejojmë që të vazhdojë disa sekonda --

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
24 pyetja është e juaja. Ju po e pyesni dëshmitarin nëse i ka  
25 parë -- Dëshmitari i ka para këta persona në uzinën e metalit

1 para a pas funeralit. Dhe ai u përgjigj: "Jo, asnjëherë". Dhe  
2 vërejtja ime është që imazhi është i paqartë dhe është -- nuk  
3 është e lehtë të dallosh fytyrat në këtë imazh. Thjesht këtë  
4 doja të vija në dukje.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Keni shumë të drejtë, prandaj dhe  
6 unë thashë më mirë lejojmë të vazhdoj disa sekonda 1, 2 a 3  
7 sekonda. Mbase dëshmitari do jetë në gjendje pastaj të  
8 identifikojë personat.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
10 këtë dëshironi avokat, në rregull, por më përpara nuk ishte e  
11 qartë, prandaj e bëra edhe unë vërejtjen. Po sigurisht mund të  
12 veproni në këtë mënyrë. Dhe thjesht për t'ju informuar kemi  
13 edhe 15 minuta përpara se ta mbyllim ditën për sot.

14 Sekretare, ju lutem, kthehuni disa sekonda pas në video  
15 dhe e shohim edhe një herë nga e para.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Dëshmitar, po tani që u -- e lamë videon të ecte pak,  
19 jeni në gjendje t'i identifikoni këta persona?

20 PË. Jo, nuk jam në gjendje t'i identifikoj se në këtë rast  
21 faktikisht kur të këqyrsh komplet këtë varrim janë 2-300  
22 ushtarë. Këta 90 për qind, faktikisht, 95 për qind nuk janë të  
23 uzinës fare. Këta kanë ardhë -- vetëm për varrim edhe nuk kanë  
24 nejt aty në uzinë, nuk kanë nejt.

25 Ne ushtarët që kemi qenë të uzinës pandërprerë aty janë



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 113

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 krejt tjetër send. Por shumica prej këtyre, 95 për qind prej  
2 këtyre ushtarëve sapo i shohim nuk kanë nejt në uzinë në atë  
3 kohë. Për q'atë arsye nuk mund me i njoh. Bo vaki e kam pa për  
4 herë të parë e kam pa e mo s'e kam pa kurrë, kurrë s'e kam pa.  
5 Se këta shumica shumica kanë qenë të brigadës së Ruzhdi  
6 Saramatit. Mbasi që janë vra ata 5 dëshmorë një pjesë shumë e  
7 madhe e ushtarëve janë tërhek prej frontit me ardhën në varrim  
8 edhe apet se apet kanë hi në front.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Dëshmitar, e thatë tri herë të njëjtën gjë. Mjafton ta thoni  
11 vetëm një herë.

12 Dhe po ju bëj, po them si vërejtje që dhe imazhi ndonëse  
13 u la të ecte pak, prapë nuk ishte shumë i qartë, video nuk  
14 ishte e qartë.

15 Vazhdoni, Avokat.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju lutem të shohim imazhin,  
17 videon numër 4 që ka ERN 078249-01, DPS00878.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
19 këtë video ju keni kërkuar katër segmente. Sa i takon  
20 segmentit të parë që doni që të shfaqet, unë kam nevojë t'ju  
21 pyes pse duhet ta shfaqim dhe një herë. E kemi parë gjatë e  
22 gjerë video me këtë përmbajtje.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Pajtohem tërësisht. Thjesht doja  
24 të tregoja vazhdimësinë për të identifikuar njësitin. Po në  
25 fakt tani e kemi informacionin.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
2 mirë atëherë. E heqim segmentin e parë.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund t'ju them, jo për t'ju  
4 përgjigjur pyetjes suaj, por këtë video e ka nxjerrë ZPS-ja me  
5 ERN 078249-01. Por kjo video ka qenë pa zë, s'ka pas fare zë.  
6 Dhe ne kemi këtë pjesë të videos me ERN -- dhe mund ta  
7 nxjerrim ERN-në DPS00878. Është e njëjta video, por thjesht që  
8 video e dytë që përmenda ka zë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
10 rregull, por në qoftë se zëri s'ka ndonjë vlerë të shtuar sa u  
11 takon të paktën pyetjeve që i bëni dëshmitarit. Pra, ju doni  
12 t'i bëni pyetje dëshmitarit lidhur me këtë video, kështu që në  
13 qoftë se zëri nuk ka ndonjë vlerë të shtuar nuk është shumë  
14 relevante.

15 Shoh që keni edhe tre video të tjera. A ka ndonjë arsye  
16 specifike pse duhet që video e 3-të dhe e 4-t duhet të  
17 shfaqen, sepse duket sikur janë në të njëjtin vend.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për të dytën besoj se mund ta  
19 heqim.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
21 04 apo 09?

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] 03:19, pra sekonda. -- më falni -  
23 - video e 4-t minuta e 13, sekonda 19. Por e treta është  
24 interesante.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 115

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 rregull e kuptoj, por e 4-ta a është e domosdoshme?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ka lidhje me numrin e varreve.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

4 kuptoj.

5 Keni edhe 8-9 minuta. Vazhdojmë. Me 04, 01.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po pa merak. Do përpiqem të  
7 mbetem brenda kohës. Ju lutem të shikojmë minutën e 4-t, deri  
8 në minutën e 6, sekondi i 2-të.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është  
10 më gjatë se ç'kishit kërkuar në parashtrimin e protokolluar.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në rregull.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtu  
13 keni thënë 5:33. A është nevoja ta dëgjojmë të gjithë  
14 fjalimin?

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, jo. Unë thashë mund ta  
16 ndalojmë përpara. Ka disa informacione që duam të nxjerrim.  
17 Dhe do doja që me lejen tuaj ta njoftoja Sekretaren e Gjykatës  
18 kur të ndalojmë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por  
20 ju nuk e dini kur.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, jo e kam një ide se kur duhet  
22 të ndalojmë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
24 atëherë. Sekretare, ju lutem, vendosni këtë segment të videos.

25 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Seancës

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (Seancë e hapur)

Faqe 116

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 këshillohen]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat, zëri duhet?

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po na duhet me zë. Kemi dhe

5 transkriptin, faqja ERN DPS00878-TR-ET, faqja 1 për

6 anglishten; ndërsa shqipja ERN DPS00878-TR-AT në faqen 1.

7 Është interesante ta bëjmë njësoj si me fjalimet e tjera që të

8 na ndihmojnë përkthyesit, ta lexojmë me zë, pra, faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,

10 me sa kuptoj unë, Mbrojtës, transkripti në shqip përkthehet në

11 anglisht nga përkthyesit. Ata, pra, ndihma e tyre është

12 thjesht të përkthejnë transkriptin që është në shqip.

13 [Luhet videoincizimi]

14 PËRKTHYESI:

15 "Me datën 2.6.1999 ra heroikisht në fushën e nderit

16 ushtari shembullor Abdurrahman Gërdellaj, i lindur me 1974 në

17 fshatin Rrenc të komunës së Dragashit. U lind në tokën e

18 bekuar shqiptare. Kur u rrit iu bë krah familjes, por pushteti

19 serb e ndoqi duke e kërkuar për shërbim ushtarak në ushtrinë

20 serbe".

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Dëshmitar, a e keni incizuar ju këtë video?

24 PË. Po, unë e kam incizu.

25 PY. Kur e keni incizuar këtë fragment?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03887 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F793  
Pyetje nga z. Gilissen Faqe 117  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 PË. Kjo është e incizume me 2 qershor 1999.

2 PY. Në cilin vend është marrë ky imazh?

3 PË. Në varrezat e Kukësit.

4 PY. Dëshmitar, a mund të na konfirmoni, ceremonia mortore e  
5 kujt ka qenë kjo?

6 PË. Ceremonia mortore e dëshmorit Abdurrahman Gërdellaj.

7 PY. Faleminderit. A keni ndonjë informacion sa i takon datës  
8 kur ka qenë?

9 PË. Më fal, s'po të kuptoj.

10 PY. Pra, a mund të na thoni datën, datën e kësaj ceremonie  
11 mortore që sapo pamë në video?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në 2  
13 qershor, po ai e tha. Po s'është nevoja ta përsërisë; ai e ka  
14 thënë këtë.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Okej. Në qoftë se nuk është  
16 nevoja po e lë.

17 Sekretare e Gjykatës, a mund të kthehemi në fillim të  
18 këtij fragmenti që të ndaloni në një moment imazhin për qëllim  
19 identifikimi, në minutën e 5-të, sekonda e 7-të.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
21 parapëlqëja që të kalonim në seancë private.

22 Sekretare, të kalojmë në seancë private.

23 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në  
24 bazë të F793

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

26 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03887(~~Seancë private~~)(Seancë e hapur)Riklasifikuar në bazë të F793  
Pyetje nga z. Gilissen Page 118  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.

1 Faleminderit.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim]

3 PY. A mund të identifikoni ose të njihni [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 PË. Mos gabofsha [REDAKTUAR], mbiemrin nuk e di.

6 Muj edhe me gabue. Nuk jam i sigurt.

7 PY. Nëse nuk jeni i sigurt, më mirë të mos e thoni.

8 PË. Nuk jam i sigurt. S'jam i sigurt.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Kalojmë në seancë publike.

11 Sekretare, të lutem, të kalojmë sërish në seancë publike.

12 Pothuajse mbaroi dhe koha për sot. Dhe 2 minuta, Avokat.

13 ~~[Seancë e hapur]~~

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kam dhe një video tjetër --

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

17 sa kohë ju nevojitet se mund të vazhdojmë dhe nesër. Kemi kohë

18 nesër plot.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Rreth një orë, rreth edhe rreth

20 një orë do thoja. Nuk jam shumë i sigurt.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

22 mbase s'e bëra pyetjen të qartë. Kjo -- ky fragment i fundit i

23 videos sa koha ju nevojitet për këtë?

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj se shumë pak.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

1 mirë të mbarojmë -- po shoh përkthyesit, a mund të -- na  
2 lejojnë përkthyesit që ta mbyllim këtë pjesë. Shoh që po  
3 pohojnë përkthyesit. Mirë atëherë, vazhdoni.

4 Vazhdoni, Avokat.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

6 Sekretare e Gjykatës, a mund të vendosni ERN DPS00878,  
7 minuta e 9, sekonda 42, deri në 9 e 57. Është e shkurtër.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
9 kjo me zë apo pa zë është? Nuk na nevojitet zëri këtu. Atëherë  
10 le të heqim transkriptin.

11 [Luhet videoincizimi]

12 Z. GILISSEN: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, sa varre ishin në ekran?

14 PË. Faktikisht, deri atë ditë kanë qenë 4 varre. Aty varre ka  
15 shumë, por faktikisht dëshmorët që i kemi varros ne janë  
16 katër.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
18 pyetjen më duket se ishte e ndryshme. Përsëriteni edhe një  
19 herë pyetjen.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim]

21 PY. Sa varre mund të shohim në këtë pamje, sipas jush?

22 PË. A nuk e shiqova aty mas, unë vetëm varret e dëshmorëve i  
23 shiqova, kurrëgjë tjetër.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj se për -- sot mjafton.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 deshët ta pyesnit a ishte një varr i ri aty. Dua që ta  
2 sqarojmë këtë.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po kjo ishte ideja. Sa varre të  
4 reja shohim në ekran, pa qivur, domethënë, me dhe.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo  
6 ishte pyetja.

7 DËSHMITARI: Është krejt diçka tjetër. Janë katër varre të  
8 reja. Se me 1 qershor 1999 janë varros tre dëshmorë; me 2  
9 qershor është varros edhe një dëshmor. Janë katër varre  
10 faktikisht. Katër dëshmorë brenda dy dite i kemi varros.

11 E dy ditë më vonë është edhe një varr masanej i ri që  
12 është edhe një varrim tjetër. -- me siguri janë edhe incizime  
13 të tjera.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo  
15 nuk na nevojitet, por nëse është nevoja mund ta diskutojmë  
16 nesër.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në rregull. Shumë e qartë,  
18 faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Faleminderit.

21 Dëshmitar, është ora 16.00. Për sot përfunduar. Do të  
22 vazhdojmë nesër më 21 nëntor. Nuk duhet të diskutoni dëshminë  
23 tuaj me asnjë person. Ju uroj një pasdite të këndshme dhe  
24 mbrëmje të këndshme, dhe Asistentja do t'ju shoqërojë tani të  
25 dilni nga salla. Faleminderit.



*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F722RED dhe F793.*

1 DËSHMITARI: Shumë faleminderit.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
4 mirë.

5 Prokuror, ka -- ndonjë gjë për të parashtruar me Trupin  
6 Gjykues?

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, s'kemi asgjë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Mbrojtësi i Viktimave?

10 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Avokat, a ka ndonjë gjë që doni të diskutoni -- tani me Trupin  
13 Gjykues?

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo. Doja t'ju kërkoja edhe një  
15 herë falje për atë -- për pyetje që s'ishin të hapura. Po  
16 kisha shumë -- e kisha shumë shqetësim kohën. Nuk po përpiqem  
17 të justifikohem, por thjesht kisha nevojë t'jua thoja këtë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit.

20 Mirë. Nesër në orën 09.30.

21 Seanca sot mbyllet.

22 --- Seanca mbyllet në orën 16.05

23

24

25